



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2024, ora 12:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE III

Drejton tryezën: Mirela Miti

Rendi i ditës:

Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin dhe luftën kundër abuzimit me financat publike, si dhe transparenca në menaxhimin e tyre.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Etilda Gjonaj, Evis Kushi, Besarda Vladi dhe Esmeralda Dida.

Të ftuar:

Ened Topi, Olta Milova, Aranita Brahja, Sotiraq Hroni, Ana Kovacevic, Sotiraq Dharmo, Zoran Jachev, Isabele Tomas Delic, Adam Norkane, Spiro brumbulli, Ardita Seknaj, Imir Kraja, Astrit Aliaj, Adriana Ristani, Blerina Naska, Esmeralda Hoxha, Xhoana Ristani, Donjet Gjoka, Adela Xhemali, Gent Gazheli, Aleksander Maskovic, Dritan Fino, Ermelinda Pema, Maldi Dema, Ilia Bili, Vjosana Neziri, Vanina Jakupi, Kozeta Pirani, Klodian Mema, Alabana Gjonopuli, Dëshira Mema, Etleva Bajrami, Reld Keta, Avjerina Bazaj, Anairda Arizaj, Stela Suloti, Fiorent Zgura, Josif Bollani, Gasper Gjeluçi, Monika Canco, Brunilda Zeneli, Rovenë Pregja, Marcela Kereku, Majlinda Thomaj, Adela Tagani dhe Bledar Mustafaraj.

HAPET MBLEDHJA

Mirela Miti – Përshëndetje!

Tre komponentët kryesorë për mirëqeverisjen janë: mirëqeverisja, sundimi i ligjit dhe antikorrupsioni për Shqipërinë 2030 në lidhje me integrimin drejt Bashkimit Europian. Tryeza e sotme publike përmban tematikën në lidhje me identifikimit të forcimit të rolit të institucional dhe të eficiencës së institucioneve që kanë përballë luftën kundër korrupsionit, si dhe elementin mjaft thelbësor që ka të bëjë përkatësisht me parimin e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e fondeve publike.

Tematika e parë ka të bëjë me komponentin e tretë të shtyllës së dytë, që është përkatësisht efienca institucionale në lidhje me luftën kundër korrupsionit, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike, e cila do të moderohet nga Ened Topi, eksperti i shtyllës.

Njëkohësisht, kemi edhe komponentin e pestë të shtylla e parë, që ka të bëjë me efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e fondeve publike, e cila do të moderohet nga pedagogia Olta Milova, njëkohësisht edhe eksperte për këtë komponent.

Pa humbur kohë fjalën për prezantim po ia jap zotit Ened Topi.

Ened Topi – Faleminderit, Mirela!

Para se të fillojë me prezantimin dua t'ju them dy fjalë në lidhje me metodologjinë që ka mbledhur grupi i punës në përgatitjen e këtij raporti. Kryesisht, metodologjia është bazuar sigurisht në progresraportet e Bashkimit Europian, por edhe tek analizat dhe studimet e organizatave të ndryshme, qoftë ato ndërkombëtare apo vendase, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile.

Para se të filloj me prezantimin, koha që kam në dispozicion është e kufizuar 10 deri në 15 minuta. Dua t'u kërkoj paraprakisht ndjesë kolegëve, ekspertëve të lartë, por edhe anëtarëve të sekretariatit teknik, pasi ky prezantim nuk do të jetë gjithëpërfshirës aq sa është raporti ynë.

Me dy fjalë raporti konsiston në rreth 400 faqe dhe pjesa e komponentit tonë është rreth 80 faqe. Pra, në këtë prezantim të shkurtër do të fokusohem te gjetjet dhe rekomandimet kryesore për ndërhyrjet e bëra nga grupi i punës.

Gjej rastin këtu të falënderoj anëtarët, ekspertë të lartë të grupit të punës, por edhe sekretariatit teknik për punën e shkëlqyer që kanë bërë gjatë një kohe të shkurtër!

Po filloj menjëherë me prezantimin. Siç jua thashë, përveç progresraportit të Bashkimit European apo edhe dokumenteve të tjera të ndryshme strategjike qeveritare kemi analizuar gjatë punës sonë edhe një sërë raportesh, sondazhesh apo studime të kryera nga organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, të huaja dhe vendase. Po e filloj prezantimin pikërisht me disa të dhëna të marra nga dy institucione të njohura për Shqipërinë, siç janë “*Transparency International*” dhe “*Freedom House*”. Siç i shihni edhe vetë, indikatorët nuk janë shumë inkurajues, fatkeqësisht. “*Transparency International*” për vitin 2023 na ka renditur në vendin 98-të nga 180 vende të mundshme dhe na ka dhënë një pikavarazh kryesisht të ulët, 37 nga 100 pikë të mundshme. Nga ana tjetër “*Freedom House*” duket sikur është më dashamirës ndaj vendit tonë duke na dhënë 3 nga 7 pikët e mundshme. E ka vlerësuar lart Shqipërinë në perceptimin e korrupsionit nga publiku, por për të qenë sa më të vërtetë duhet të theksoj se përveç sondazheve të këtyre dy instituteve, ne kemi vërejtur edhe sondazhet e tjera të bëra, sidomos shoqëria civile apo organizata të tjera të huaja kanë të njëjtën qasje apo tregojnë të njëjtat të dhëna, që perceptimi i publikut ndaj korrupsionit është shumë i lartë në Shqipëri, disa herë është në shifra, le të themi, alarmante, duke arritur në shifrat 80 ose 90%.

Çfarë tregon kjo? Kjo tregon që korrupsioni shihet nga qytetari shqiptar si një nga kërcënimet kryesore ndaj shoqërisë, por edhe sigurisë së vendit. Për të qenë sa më konsistent edhe me qasjen strukturore të raportit, por edhe me mënyrën e analizës sonë në raport dhe në prezantim kemi marrë qasjen e përdorur nga raportet e Bashkimit European në lidhje me Shqipërinë. Pra, në lidhje me kapitullin XXXII “Kontrolli financiar” ne kemi marrë të njëjtën renditje që ka përdorur edhe Bashkimi European për të analizuar sektorët e veçantë në këtë kapitull.

Po e filloj me kontrollin e brendshëm financiar publik. Raportet e Bashkimit European, por edhe organizatat e tjera kanë të njëjtin mendim, shprehen se Shqipëria është përgatitur mesatarisht në fushën e kontrollit financiar. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe *acquis*. Ky ligj pësoi ndryshime të rëndësishme në vitin 2023 për të përmbushur disa nga rekomandimet e lëna nga Bashkimi European në progresraportet e mëhershme. Si rezultat i këtyre ndryshimeve të vitit 2023 janë ashpërsuar masat sanksionuese.

Ndoshta po eci pak shpejt, por fushat që do të preken janë shumë, kështu që përveç përgatitjeve të mia para pasqyrës asnjëherë nuk shkova poshtë 20-minutëshit, prandaj ju kërkoj ndjesë nëse eci pak shpejt, këtë e kam më shumë për përkthyesit.

Një hap tjetër i rëndësishëm është edhe miratimi i strategjisë sektoriale të menaxhimit të financave publike për periudhën 2023-2030 me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave në qershor të këtij viti. Pra, është një vendim i hershëm dhe tashmë kemi një strategji të miratuar, ndërsa në aspektin institucional, për atë që jemi mbledhur sot, progres-raportet vlerësojnë se njësia qendrore e harmonizimit monitoron në mënyrë aktive zhvillimet në fushën e kontrollit të lartë publik, fushë e veprimit të saj. Pra, vërehet që kemi një progres, kemi arritje, por, pavarësisht këtyre arritjeve kemi edhe rekomandime dhe rekomandimet nga hulumtimi ynë vijnë nga larg, pra nuk janë të hershme. Progresraporti i vitit 2024 i publikuar jo më larg se 10 ditë më parë, në mos gaboj, vazhdon dhe insiston në tri rekomandime kryesore në lidhje me këtë aspekt të komponentit tonë, që janë, forcimi i përgjegjshmërisë menaxheriale, zbatimi në praktikë i delegimit të detyrave administrative dhe një sistem menaxhimi risku ende në fazë të hershme, pra në gjenezën e tij. Them se këto rekomandime vijnë nga larg, 2 ose 3 vjet më parë, sepse edhe raporti i monitorimit të menaxhimit të financave publike i vitit 2022 i kryer nga Ministria e Financave thekson pikërisht këto mangësi le të themi, pra një mangësi në lidhje me forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale, zbatim efektiv i delegimit të detyrave administrative apo edhe një sistem menaxhim risku ende në fillimet e tij.

Thënë këtë, këtu dua të bëj një paratenzë të shkurtër në lidhje me rekomandimet e grupit të punës, të cilat shpeshherë kanë qenë të debatuar dhe jo të mirëmiratuara ose të miratuara nga i gjithë grupi i punës. Shpeshherë një anëtar i grupit tonë ka pasur një mendim ndryshe, një mendim radikal, një mendim më konform qasjes së Bashkimit Europian, dhe këtu do të shohim shembullin e parë. Pra, lidhur me forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale propozimi ynë shkon drejt rekomandimit të Bashkimit Europian për ndërhyrje kryesisht në aktet nënligjore në mënyrë që të përcaktohen detyrime të qarta për raportimin e progresit të objektivave dhe të përdorimit të fondeve, duke bërë transparente rezultatet dhe masat e marra për të adresuar risqet dhe parregullsitë.

Lidhur me menaxhimin e riskut propozimi ynë shkon pikërisht në linjë me rekomandimin e Bashkimit Europian në lidhje me ndërtimin e një sistemi të dedikuar për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve që rrezikojnë arritjet e objektivave të njësive publike, kjo

sigurisht e bazuar në një metodologji të qartë. Kryesisht, këto dy ndërhyrje vlerësohen dhe janë të pranuar nga grupi që duhet të bëhen në nivel aktesh nënligjore, pra pa cenuar ligjin e posaçëm.

Në lidhje me rekomandimin e tretë, delegimin e detyrave administrative, siç jua thashë pak më lart, rekomandimi i Bashkimit European shkon drejt zbatimit në praktikë, që do të thotë kemi një kuadër legjislativ në përputhje me standardet ndërkombëtare, nuk duhet të bëjmë asgjë në këtë drejtim, por praktikisht udhëzimet apo efektiviteti i delegimit të detyrave duhet të përforcohet. Këtu grupi i punës ra dakord të bënte një ndryshim, paksa radikal, joortodoks, të shkonim përtej rekomandimeve të Bashkimit European dhe të bënim ndryshime te ligji i posaçëm, duke ndryshuar në mënyrë të kufizuar dy apo tri aspekte të vogla që do t'i jepnin eficiencën e duhur pikërisht delegimit të këtyre detyrave, duke e “forcuar” titullarin e njësisë apo nëpunësin e parë të autorizuar të ishte sa më efektiv në delegimin e këtyre detyrave.

Një tjetër rekomandim thelbësor, do të thosha se përsëri konsiston në një ndërhyrje edhe këtu shumë radikale, në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin pikërisht në lidhje me aspektin e bordit të kontrollit të brendshëm financiar publik. Aktualisht, në ligj ky bord përbëhet nga ministri i Financave, i cili ka edhe rolin e kryetarit të bordit, nëpunësit të paautorizuar, drejtues i strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar e të tjera. Bordi duhet thënë se ka një kompetencë këshilluese, pra në mbledhjen e tij ai analizon raportin vjetor të kontrollit të brendshëm, i cili më pas miratohet nga ministri i Financave. Thënë këtë, ne këtu shohim një konflikt interesi, sepse bordi nuk mund ta diskutojë raportin vjetor dhe më pas ky raport të miratohet nga ministri i Financave. Pra, ministri i Financave shihet në dy role, si kryetar i bordit, por edhe si një miratues i këtij raporti. Për këtë, edhe në drejtim të forcimit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe një sigurimi të paanësisë dhe pavarësisë së këtij bordi ne propozojmë që të ndërtohet një strukturë e pavarur. Struktura e pavarur duhet të përfshijë kontrollin dhe auditin e brendshëm, por edhe të miratohet nga Parlamenti me një mandat të mirëpërcaktuar.

Sa i përket auditit të brendshëm progresraporti i vitit 2024 përsëri shprehet pozitivisht në lidhje me ecurinë e Shqipërisë. Kuadri legjislativ është në përputhje me standardet ndërkombëtare, ligji për auditimin e brendshëm në sektorin publik që u ndryshua në vitin 2023 forcoi pavarësinë e auditit të brendshëm. Gjithashtu, me ndryshimet e vitit 2023 ky ligj shfuqizoi edhe të drejtën e kontraktimit të jashtëm të shërbimit të auditimit, pra e thënë shkurt tashmë

forcohet pozita e institucioneve që ta kontraktjnë jashtë organizatës së tyre shërbimin e auditimit të brendshëm.

Sipas mendimit tim personal, do ta shohim edhe në fund të këtij prezantimi kur të diskutojmë tezat tona për diskutim, këtu kërkoj të gjithë bashkëpunimin tuaj për të marrë rekomandime sa më të qenësishme apo edhe vërejtje në lidhje me tezat që do të propozojmë, mendoj se këtu ka hapësirë edhe për më tepër. Pra, siç do të shihet edhe më vonë unë jam edhe pak më radikal në këtë sens.

Gjithashtu, strategjia sektoriale e menaxhimit të financave publike e thekson rëndësinë e transpozimit në legjislacion, siç e pamë është bërë, pikërisht në lidhje me kontraktimin e këtyre shërbimeve të auditimit të jashtëm jashtë strukturës organizative të njësisë publike.

Sigurisht, rekomandimet e BE-së vazhdojnë të ekzistojnë edhe në këtë fushë, auditimi i brendshëm nuk ngelet jashtë, dhe kryesisht drejton te zbatueshmëria e legjislacionit dhe forcimi i ndikimit të aktivitetit të brendshëm. Thënë shkurt, kjo si bëhet? Rekomandime të posaçme janë trajtimi i mungesave të burimeve njerëzore, rritja e auditorëve të brendshëm, sepse në vitin 2023, sipas progresraportit të vitit 2024, numërohen 441 auditorë të brendshëm nga të cilët vetëm 353 kanë certifikim bazë. Ndërkohë, njësia qendrore e harmonizimit, përsëri sipas progresraportit të vitit 2024, e cila ka vlerësuar përputhmërinë me standardet e 19 njësive përkatëse ka gjetur se vetëm 37 prej tyre, pra një shifër tejet e ulët, ishin pjesërisht ose plotësisht me standardet e kërkuara krahasuar me 36% që ishte në vitin 2022.

Gjithashtu, një rekomandim i qenësishëm i Bashkimit Europian lidhet me monitorimin e rekomandimeve, që vlen për njësitë e auditit. Në raportin *screening Albania* 2023 theksohet se monitorimi i rekomandimeve nuk mundëson nxitjen e zbatimit efektiv të këtyre rekomandimeve dhe në këtë mënyrë kufizon ndikimin përfundimtar të auditimit. Grupi i punës, sa u përket propozimeve për ndërhyrje, edhe këtu ka marrë një qasje disi joortodokse, duke forcuar pozitën e Komitetit të Auditimit. Sot për sot në bazë të legjislacionit të zbatueshëm Komiteti i Auditimit emërohet nga titullari i njësisë publike. Gjithashtu, titullari i njësisë publike merr raporte nga njësia e auditit të brendshëm. Faktikisht, këtu shohim një konflikt të pastër interesash dhe për këtë ne kërkojmë ose sugjerojmë që të pavarësohet apo edhe të rritet objektiviteti i auditimit duke forcuar pikërisht Komitetin e Auditimit. Fillimisht anëtarët e Komitetit të Auditimit nuk duhet të emërohen nga titullari i njësisë publike, sipas mendimit tonë, si dhe raportimet e njësive përkatëse të mos bëhen më te titullari i njësisë publike, por të bëhen drejtpërdrejtë te Komiteti i

Auditimit, i cili do të ketë edhe një lloj vetoje në lidhje me miratimin apo shkarkimin e punonjësve që bëhen pjesë e kësaj njësie.

Kemi një shembull shumë të mirë, të cilin unë e përmend në çdo tryezë që shkoj, ai i Drejtorisë Antikorrupsion dhe i koordinatorit antikorrupsion, të cilët funksionojnë apo vendosen në njësi të ndryshme publike, por mbarëvajtja e punësimit të tyre nuk varet thjesht nga titullari i asaj njësie, po merret edhe një farë miratimi nga koordinatori i përgjithshëm antikorrupsion.

Më falni, se e shoh që jam përtej çdo lloj pritshmërie!

Po vazhdoj shpejt e shpjet me pjesët e tjera, pavarësisht se jam te gjysma.

Sa i përket inspektimit financiar publik kuadri rregullator dhe legjislativ vlerësohet në përputhje me *acquis* dhe standardet ndërkombëtare. Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik vlerësohet se i përmbush të gjitha standardet e kërkuara nën varësinë e Ministrisë së Financave. Këtu përsëri kemi një propozim ndryshe, pasi nga studimi që u kemi bërë dokumenteve të organizatave të ndryshme, kryesisht SIGMA-s, udhëzuesit për respektimin financiar të vitit 2023, kemi vërejtur, ose më mirë kemi parë, disa alternativa ndaj varësisë dhe raportimit direkt te Ministria e Financave. Për vendet në tranzicion si Shqipëria rekomandohet, jo fort, ose shihet se ka një alternativë të dytë apo edhe një alternativë të tretë. Ne kemi marrë si shembull alternativën e tretë që është një drejtori, përsëri në varësi të Ministrisë së Financave, por që raporton drejtpërdrejtë në Këshillin e Ministrave. Kjo do të shmangte çdo lloj problematike që mund të shkaktohet ndaj punës së kësaj drejtorie nga zyrtarë të lartë brenda Ministrisë së Financave. Është çështje hipotetike, por vlen të theksohet që raporti i SIGMA-s e ofron si një alternativë shumë të suksesshme.

Përsëri në lidhje me inspektimi financiar publik nga hulumtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga vetë drejtoria shohim dy mangësi thelbësore.

E para, problematika e burimeve njerëzore, sidomos angazhimi i ekspertëve të jashtëm pjesë e administratës publike.

E dyta, varfëria në opinione apo në mendime e strukturave apo e organizatave të ndryshme të njësisë qendrore dhe vendore.

Lidhur me këto dy problematika të evidentuara edhe nga vetë drejtoria, ne sugjerojmë forcërisht, e para, ndryshimet në legjislacion, për t'i bërë më përgjegjës titullarët e njësive publike duke vendosur masa shtrënguese apo sanksionuese në rast mosbashkëpunimi me drejtorinë. Një tjetër rekomandim, që është pak abstrakt dhe që nuk mund të japë besoj efekte të

menjëhershme, është nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit edhe me elemente detyruese ndërmjet tyre, midis drejtorisë apo Ministrisë së Financave me institucionet e pavarura apo edhe me njësitë e qeverisjes vendore. Kjo do të mundësonte rritjen e eficiencës së raportimeve të këtyre njësive ndaj drejtorisë përkatëse, pasi tashmë e dimë që kjo drejtori funksionon vetëm me sinjalizime ose informacione.

Mirela Miti – Ndjesë, por, të lutem, përqendrohuni vetëm te gjetjet kryesore dhe propozimet sa i përket pjesës së mbetur, sepse koha vazhdon, pavarësisht dëshirës së madhe që kemi mbi të gjithë punën e realizuar nga secili prej jush!

Ened Topi – E kuptoj fare mirë, më falni edhe një herë, pasi unë *disclaim*-in tim e bëra që në fillim!

Po vazhdoj me shpejtësi.

Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit European

Këtu vihet re që kemi një institucion të mirorganizuar, por kemi mungesa në miratimin e strategjisë sektoriale për mbrojtjen e interesave të Bashkimit European. Rekomandimi ynë, i cili është i pasqyruar edhe në strategjinë sektoriale të menaxhimit të financave publike, është që të miratohet sa më shpejt kjo strategji kombëtare kundër mashtrimit, e cila, sipas kësaj strategjie duhet të bëhet brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2026.

Faktikisht, aty ka një gabim, një lapsus, më falni!

Sa i përket Kontrollit të Lartë të Shtetit këtu do të ndalem shkurtimisht. Vlerësohet se kuadri legjislativ dhe organizativ është në përputhje me *acquis* dhe me standardet ndërkombëtare. Faktikisht, këtu ndahen mendimet e ekspertëve, kështu që unë do të paraqes një mendim ose një tezë për diskutim vetëm në fund të këtij takimi ose gjatë fazës së diskutimeve. Kontrolli i Lartë i Shtetit vazhdon të kryejë detyrën e tij bazuar në raportet e KLSH-së, ndoshta kjo është *eksparte*, por theksohet nevoja për përmirësimin e përcjelljes së informacionit te qytetarët, të vazhdohet me sistemin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve e të tjera.

Po e kaloj shpejt Kontrollin e Lartë të Shtetit për të ndaluar te dy institucionet bazë në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit antikorrupsion dhe hetimit administrativ, që janë Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikt të Interesave, me këtë ankronimin e padeshifruar asnjëherë nga unë.

Këtu thjesht dua të bëj një parantezë. Edhe në tryezat e mëparshme kemi vërejtur një farë mbivendosjeje midis njësive përgjegjëse, sipas ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e

sinjalizuesve dhe koordinatorit antikorrupsion, që është në varësi apo pjesë e “organikës” e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion. Pse e them këtë? Sepse, siç jua thashë kjo është trajtuar gjerësisht edhe në tryezat e tjera dhe këta dy zyrtarë kanë një farë mbivendosje në lidhje me luftën e tyre apo me kompetencat funksionale të tyre. Sugjerimi ynë, i cili është ndarë edhe me kolegët më herët, është që të bëhet një ristrukturim i këtyre detyrave dhe të mos ketë një mbivendosje të tillë. Mendimi im personal është që të anohet drejt forcimit të kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion. Siç jua thashë ky është mendim personal.

Propozimet për ndërhyrje kryesore, siç jua thashë, janë ato që diskutuam më herët gjatë prezantimit, gjë që besoj se e mbyllëm.

Po vij tek tezat për diskutim publik. Faktikisht, kemi më shumë se dy teza për diskutim publik, për këtë do të dëshiroja edhe mendimin tuaj, siç ju thashë pres vërejtjet dhe sugjerimet tuaja për të përmirësuar edhe punën tonë. Dua ta theksoj edhe një herë se raporti është përfundimtar nga aspekti formal, por ne si grup ekspertësh vazhdojmë t’i rrahim mendimet kështu që çdo rekomandim apo sugjerim juaji është më se i mirëpritur.

Faleminderit!

Mirela Miti – Faleminderit, Ened!

Fjalën do t’ia jap zonjës Olta Milova, për të bërë prezantimin e saj në lidhje me efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike.

Olta Milova – Mirela, faleminderit!

Menaxhimi i financave publike është një nga komponentët e rëndësishëm për të pasur një mirëqeverisje dhe duke qenë efektiv dhe transparent ky proces e arrin më së miri misionin e tij. Duke qenë se ai ka si qëllim që të garantojë transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale, efikasitet dhe barazi në përdorimin e burimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik në këtë mënyrë kontribuon edhe në lehtësimin e procesit të aderimit në Bashkimin Europian.

Në këtë kontekst Shqipëria ka zbatuar një sërë reformash në kuadrin e menaxhimit të financave publike në dekadat e kaluara dhe aktualisht ajo mbështetet në strategjinë sektoriale të menaxhimit të financave publike dhe planin e veprimit. Kjo strategji ka, gjithashtu, edhe disa strategji plotësuese, të cilat janë të listuara aty, kështu që nuk po ndalem edhe për arsye të kohës, por që ato ndikojnë pozitivisht në arritjen e objektivave dhe qëllimeve që ka strategjia në drejtimin e menaxhimit të financave publike.

Në lidhje me ecurinë bazuar te raportet e monitorimit të strategjisë së vitit 2022, grupi ynë i punës ka nxjerrë disa progrese dhe arritje në lidhje me të gjitha objektivat dhe komponentët që përfshihen në strategji. Po filloj me kapacitetin parashikues në të cilin ka përmirësime dhe kjo reflektohet me matjen e PBB-së nominale në vlera më të ulëta sesa ato të parashikuara nga organizmat ndërkombëtare. Gjithashtu, identifikimi dhe kontrolli i rreziqeve fiskale është bërë më efektiv nëpërmjet krijimit të njësisë së riskut fiskal, e cila është përgjegjëse për analizimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale të qeverisë. Një komponent i rëndësishëm është edhe zgjerimi i monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, duke qenë se ato janë edhe një element që mbartin një risk fiskal.

Përmirësime të dukshme janë bërë edhe në procesin e dokumentacionit të buxhetit vjetor dhe në programin buxhetor afatmesëm nëpërmjet asistimit të ekipeve të menaxhimit të PBA-së, trajtimit mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe integrimin e tij në të gjitha programet buxhetore në nivel vendor. Gjithashtu, përmirësime janë bërë edhe në drejtim të monitorimit të menaxhimit të investimeve, ku qëllimi kryesor është rritja e përputhshmërisë ndërmjet objektivave strategjike të vendit dhe prioritetëve të qeverisë në procesin e PBA-së për të pasur një orientim të investimeve sa më afër me objektiva strategjikë. Në këtë kontekst është edhe krijimi i listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare, e cila është përditësuar dhe është e bazuar në metodologjinë standarde të hartuar nga SASPAC-u me asistencën e Bashkimit European.

Krijimi dhe miratimi i strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit është përsëri një arritje, e cila ka ndikuar pozitivisht si në analizimin periodik të qëndrueshmërisë së borxhit, edhe në menaxhimin e likuiditetit të tij. Vlen të përmendim që për vitin 2023 borxhi ka pasur një rënie krahasuar me vitin e mëparshëm dhe është në vlerat 58,9% të produktit të brendshëm bruto. Përmirësime janë bërë edhe në ligjin e prokurimit publik për ta përafruar atë me direktivat dhe me legjislacionet e Bashkimit European.

Sa i përket llogaridhënies dhe transparencës ka një përgatitje të llogarive kombëtare sipas standardeve ndërkombëtare, dhe një publikim të raporteve financiare gjatë periudhave të fundvitit ose gjatë vitit, pra për të treguar ecurinë e tyre. Këtu kemi të vendosur disa nga treguesit e performancës, që kanë pasur përmirësim në lidhje me përgatitjen e llogarive kombëtare, ku vlen të përmendim që 89, 25% e tabelave të plotësuara janë dërguar në Eurostat; 15 nga 39 raportet monitoruese të paraqitura nga ministritë e linjës janë në përputhje me sistemin

informativ të menaxhimit financiar shqiptar; gjithashtu, ka pasur progres në masën 40% në paraqitjen e pasqyrave financiare të qeverisë, ku kontabiliteti paraqitet në bazë të të drejtave dhe të detyrimeve të konstatuara.

Sa i përket auditimit të brendshëm, unë nuk do të ndalem, pasi ishte edhe fokusi i prezantimit të kaluar, por ne kemi renditur disa nga arritjet, pikërisht në këtë drejtim, ku vlen të përmendim miratimin e ligjit për auditimin e brendshëm, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore gjatë viteve, të cilat kanë qenë pikërisht në mbështetje të legjislacionit parësor. Përmirësime janë bërë kryesisht në treguesit e metodologjisë, sa i përket nivelit të zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm brenda institucioneve buxhetore dhe sa u përket mekanizmave për llogaridhënien menaxheriale në kuadrin rregullator. Kështu, bazuar tek treguesit e performancës në drejtim të auditimit të brendshëm, janë adresuar 76% e rekomandimeve bazuar në sistemin e auditimit dhe janë zbatuar 90% e rekomandimeve të inspektimit financiar, si dhe janë trajnuar 75% e inspektorëve.

Për sa i përket mbikëqyrjes së jashtme, ka vazhduar forcimi i funksionimit të mbikëqyrjes, duke e sjellë atë në përputhje me standardet ndërkombëtare, pra të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Pavarësisht të gjitha këtyre arritjeve dhe elementeve të tjera, të cilat ndoshta nuk janë përfshirë, ndërkohë që në material janë të detajuara dhe të paraqitura në mënyrë më të gjerë, ne kemi adresuar edhe një sërë problematikash, bazuar në raportet e brendshme, por kryesisht në raportet e Bashkimit Europian, duke përmendur edhe progresraportin e fundit të muajit tetor. Problematika kryesore që ne kemi evidentuar dhe duhet të adresohet është përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve parashikuese, i cili është i lidhur kryesisht me rishikimin e shpeshtë të buxhetit brenda vitit nëpërmjet akteve normative. Kështu, një nga direktivat kryesore të raportprogresit të fundit ka qenë pikërisht kthimi drejt një procesi të rregullt të rishikimit të buxhetit, duke u bazuar në ligjin për buxhetin dhe ndryshimet që realizohen në Parlament. Këtu ne adresojmë pikërisht Parlamentin, për të forcuar rolin e tij mbikëqyrës mbi ekzekutivin, sa u takon buxhetit të shtetit dhe financave publike, për verifikimin e akteve normative.

Në lidhje me analizën e riskut fiskal, edhe këtu rritja e kapaciteteve do të ishte një çështje për t'u adresuar, në lidhje me krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm për të monitoruar dhe për të zbatuar rregullat fiskale, siç është ngritja e një këshilli fiskal, si dhe publikimi i pasqyrave periodike të risqeve fiskale. Gjithashtu, në këtë pjesë jemi ndalur edhe në përmirësimin e

kontrollit financiar të sektorit të ndërmarrjeve shtetërore, i cili është një sektor i rëndësishëm, që mund të ndikojë negativisht sa u përket risqeve fiskale. Këtu jemi fokusuar dhe kemi adresuar çështje të cilat lidhen me aspektet ligjore. Ligji për të bërë të mundur tjetërsimin e aseteve duhet të garantojë pikërisht procedura të drejta, me konkurrueshmëri dhe eficiencë buxhetore të tjetërsimit të pronave publike; gjithashtu, bazën ligjore, e cila lejon auditime të jashtme periodike të ndërmarrjeve me zotërim publik nga auditues publikë, siç është KLSH-ja; ndërhyrjet institucionale, duke rritur rolin e Parlamentit dhe të komisioneve përkatëse, të cilët mund të angazhohen në dëgjesa, raportime, seanca dhe diskutime parlamentare; si dhe përmirësimin e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, me qëllim evidentimin e të dhënave dhe pronësisë përfituese për çdo subjekt që fiton statusin kontraktor, i angazhuar përmes një kontrate apo marrëveshjeje me kundërshtpërblim.

Gjithashtu, sa u përket prokurimeve publike, duhet të vijojë përmirësimi i procedurave që rrisin konkurrencën në procesin e prokurimit. Këtu mund të përmendim përafrimin me kuadrin ligjor të BE-së për koncesionet dhe PPP-të, si dhe marrëveshjet ndërqeveritare të realizuara me vendet e treta.

Lista unike e projekteve me rëndësi, e cila...

Mirela Miti – Më falni, që po ndërhyj! Nëse mundeni, pak më shkurt, ju lutem!

Olta Milova – Patjetër, por mendoj se jam në rregull me kohën.

Mirela Miti – Koha kalon, pavarësisht dëshirës sonë të madhe. Ju lutem, përqendrohuni vetëm te çështjet e rekomandimeve ose te gjetjet kryesore, të cilat ne i kërkojmë në këtë tryezë, për të marrë njëkohësisht edhe mendime në lidhje me to!

Olta Milova – Kam vetëm 2-3 *slide*. Këto janë çështjet që duhet t'i adresojmë, të cilat unë po i përmend pa u ndalur gjerësisht.

Sa i përket listës unike të projekteve me rëndësi, renditja e projekteve sipas rëndësisë strategjike, financimit dhe maturimit duhet të plotësohet më tej, duke përfshirë edhe amendime ligjore për përfshirjen e kontratave të partneritetit publik privat, si pjesë të kësaj liste. Po kështu, edhe menaxhimi i investimeve publike dhe proceset e partneritetit publik privat duhet të harmonizohen dhe të integrohen plotësisht në ciklin buxhetor.

Në lidhje me të ardhurat, miratimi sa më shpejt i strategjisë afatmesme të të ardhurave, duke përfshirë të gjitha plotësimet e mundshme, si nga ato që do të merren nga konsultimi publik në të cilin është aktualisht, ashtu edhe nga adresimet e raporteve europiane, siç janë rishikimi i

përrjashtimeve tatimore; përafrimi i normave tatimore me ato të BE-së, që lidhen kryesisht me TVSH-në dhe akcizën; thjeshtimi i sistemit tatimor dhe zgjerimi i bazës së tatueshme për të ulur evazionin dhe për të rritur pajtueshmërinë, që është edhe një problematikë e cila e shoqëron mbledhjen e taksave të ne; gjithashtu, zhvillimi i kadastrës, për të pasur një regjistrim, i cili do të lidhte dhe do të përditësonte informacionet për pronat dhe tatimpaguesin, si dhe kapacitetin e bashkive për të administruar tatimin në pronë në mënyrë të decentralizuar dhe problematikat që lidhen me menaxhimin e aseteve jofinanciare, regjistrimi i të cilave në institucionet buxhetore është i mangët, ku mungon një regjistër i vetëm dhe i plotë i aseteve.

Ndërkohë, në aspektin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm, për të përmirësuar dhe për të rritur qëndrueshmërinë në parashikimin e saj, do të sugjerim vendosjen e një treguesi performance në strategjinë e re, i cili të mund të tregonte diferencën ose devijimin e kufijve të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm dhe atyre në buxhetin e miratuar, pra diferencën e kufijve për të përmirësuar parashikueshmërinë.

Forcimi i kapaciteteve të Parlamentit për të shqyrtuar raportin e zbatimit buxhetor vjetor do të ishte gjithashtu një çështje për t'u adresuar, si dhe ngritja e një nënkomisioni të auditimit publik në Parlament do të kontribuojë në drejtim të forcimit të auditimit të qeverisë dhe rritjes së cilësisë së raporteve.

Ndërkohë, tezat për diskutim, të cilat ne i kemi sugjeruar, janë pikërisht ato që lidhen me mënyrat se si mund të rritet transparenca, formën që duhet të ketë këshilli fiskal, se si mund të përfshihen shoqëria civile, qytetarët dhe Akademia në menaxhimin e financave publike, kuadrin e plotë ligjor për të garantuar transparencën e financave publike, efikasitetin e politikave të llogaridhënies menaxheriale brenda institucioneve, nëse janë efektive mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit në Shqipëri, si dhe se si mund të kontribuojë Kuvendi i Shqipërisë në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së qytetarëve në menaxhimin e financave publike.

Faleminderit!

Mirela Miti – Faleminderit, zonja Milova!

Zonja Brahja, do t'jua jap fjalën më vonë, pasi të bëj një njoftim.

Tani është momenti kur ne mund të zhvillojmë edhe diskutimet e hapura në lidhje me tezat dhe çështje të cilat u adresuan në këtë tryezë publike. Njëkohësisht, zonja Brahja, mund të diskutoni edhe në lidhje me çështjet përkatëse.

Aranita Brahja – Faleminderit!

Unë quhem Aranita Brahja dhe vij nga një organizatë e shoqërisë civile, e cila prej vitesh ka një rol në monitorimin e shpërndarjes së financave publike, pra të parave publike dhe të kontratave publike. Në krye të herës, organizata, si pjesëmarrëse, dhe, unë, si eksperte në Kapitullin V, i cili ka të bëjë me financat publike dhe me buxhetin e shtetit, duam të shprehim arsyen pse morëm vendimin për t'iu përgjigjur ftesës së Kuvendit për të marrë pjesë në këtë komision të posaçëm, ndërkohë që shumë organizata e kishin të vështirë ta merrnin.

Së pari, kemi konsideruar që Kuvendi ka shumë për të bërë sa i përket ushtrimit të detyrave të tij, rolit të tij në legjislativ, por edhe në mbikëqyrje, sidomos në çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen financiare ose të buxhetit të shtetit, apo *oversight public finance*. Menduam se ka vend për të krijuar grupe pune dhe për të dizajnuar një plan veprimi për atë që vetë Kuvendi mund të bëjë më mirë, duke ushtruar rolin e tij, për iniciativat ose veprimet e tij legislative apo institucionale më afatshkurtra dhe më të shpejta dhe ato që mund të dizajnohen në një afat më të gjatë, në legjislaturën tjetër apo edhe më tej.

Nga ana tjetër, menduam se Kuvendi nuk mund ta bëjë këtë pa partneritetin e aktorëve civilë, qofshin aktorë nga universitetet dhe Akademia, qofshin nga aktorët e shoqërisë civile, të organizatave të angazhuara në *rule of law* apo organizatave të angazhuara në monitorim deri edhe në *watch dog*.

Me këtë dëshirë, duke konsideruar edhe të gjitha shqetësimet e kolegëve të tjerë, qofshin këto edhe për kohën kur u zgjodh për ta krijuar këtë komision, me sfidat, vështirësitë apo problematika të tjera jashtë kontekstit, ne vendosëm të marrim pjesë dhe zgjodhëm të ndihmojmë me kapacitetet tona, që kanë të bëjnë me Kapitullin V, të mirëqeverisja, që ka të bëjë me rolin mbikëqyrës të Kuvendit, sa u përket financave dhe buxhetit të shtetit.

Pikërisht këtu, unë përfitoj nga rasti, shpresoj sa më shkurt, të parashtroj disa çështje për diskutim, të cilat kanë të bëjnë me edhe me advokimin e shoqërisë civile për përmirësimin e rolit të Kuvendit, por edhe me atë që Kuvendi mund të bëjë më mirë. Është prekur gjatë analizës, por edhe në konkluzionet finale, që Kuvendi i Shqipërisë nuk duhet të tolerojë ekzekutivin në aplikimin e ligjeve speciale apo akteve normative, të cilat prej shumë vitesh, më shumë se 4 legjislatura, janë të rëndësishme, sepse e ndryshojnë buxhetin e shtetit, duke e bërë buxhetin fillestar të miratuar me ligj një buxhet komplet të ndryshëm, për shkak të ligjeve speciale. Ligjet speciale apo aktet normative janë të rregulluara në Kushtetutën e Shqipërisë. Ato lejohen vetëm në situatat e emergjencës së jashtëzakonshme, por çështja e interpretimit të emergjencës ka bërë

që Kuvendi, 2, 3 apo në ndonjë rast edhe 4 herë në vit, t'i përdorë këto akte normative, duke sjellë rregullime të financave publike krejt të ndryshme nga ato që janë diskutuar, janë bërë transparente për publikun dhe janë vendosur me një procedurë të rregullt legislative në muajin dhjetor. Ne sugjerojmë që Kuvendi fare mirë mund të përdorë edhe procedurën e një ligji të përshpejtuar, por në asnjë rast nuk duhet t'i japë të drejtë qeverisë të drejtojë në planifikimin dhe në hartimin e buxhetit të shtetit totalisht pa kontroll, pa *oversight of the Parliament*, përmes akteve speciale. Këto janë përdorur nga mazhoranca të ndryshme, pra nuk është vetëm tipologji e një mazhorance të caktuar.

Një element tjetër është diçka e cila është e rregulluar shumë mirë në ligj, pra legjislacioni shqiptar ia njeh të drejtën Kuvendit që për çdo ligj që vjen e miratohet të bëjë një vlerësim dhe një kërkesë të qartë nga ekzekutivi ose nga pala që bën iniciativën ligjore se sa janë kostot financiare të këtij ligji apo të kësaj ndërhyrjeje ligjore. Ajo që dua të konstatoj është se nuk ka nevojë për ndonjë rregullim ligjor, por ka nevojë për një disiplinë të ushtruar shumë mirë nga Kuvendi, sepse kohët e fundit kemi parë ligje të cilat vijnë pa referenca të qarta financiare dhe, duke ardhur të tilla, i japin mundësi edhe mosdisiplinës fiskale, sidomos për listën e investimeve apo për planin afatmesëm të buxhetit të shtetit, i cili duhet të rregullojë qartë se cilat janë kostot financiare të parashikuara dhe të miratuara. Këtu ka vend edhe për shoqërinë civile, për të bërë një monitorim. Ne kemi një numër ligjesh, të cilat edhe gjatë vitit të fundit kanë kaluar në Parlament, por nuk gjejmë dot se sa do të jetë kostoja e këtij ligji apo e kësaj ndërhyrjeje ligjore, as në relacionin shoqëruar, i cili është dokument i rëndësishëm i procesit legjislativ, por as në planin afatmesëm të buxhetit të shtetit. Ndonjëherë fillojmë të mendojmë se mund të jenë ligje të parashikuara me kosto të injektuara nga privati apo PPP-të, siç i quajmë.

Është edhe një sektor tjetër ku ne kemi kërkuar shumë disiplinë, sa i përket kontrollit financiar, dhe për fat të mirë, megjithëse kemi punuar në mënyrë të ndarë, shoh që kemi derivuar në rezultate të ngjashme edhe me antikorrupsionin, edhe me shumë aktorë, ndoshta, nga shoqëria civile. Për shembull, vlerësoj shumë artikullimin që kanë bërë koleget e shoqatës “Altri”, i cili ka të bëjë me shoqëritë me zotërim publik. Është theksuar tashmë që ky është një sektor me shumë risk. Për të mos rënë në përsëritje me atë që paraqitën kolegët tanë në tryezën e të martës së shkuar, dua të them se ka nevojë për ndërhyrje ligjore në këtë sektor, sikurse u përmend edhe nga zonja Milova në parashikimet e saj. Ndërhyrjet duhet të jenë të tilla që në këtë sektor, në mënyrë kategorike, së pari, Parlamenti të rregullojë bazën ligjore, sepse edhe aty kemi një ligj special që

bën të mundur privatizimin e aseteve shtetërore të ndërmarrjeve publike, pra të ndërmarrjeve me zotërim publik, dhe, së dyti, duhet të kemi parasysh që në këtë ndërmarrje nuk mund të privatizojmë prona, pa e pasur të qartë se cili është treguesi financiar i këtyre pronave dhe aseteve, pra pa pasur një regjistrim në regjistrin elektronik të pronave, pa pasur një regjistrim të qartë të vlerave të tregut apo se sa janë vlerësuar këto prona. Akti normativ i vitit 2008, i cili pësoi edhe disa ndryshime në vitin 2024, është një ligj që duhet vënë në agjendën e Parlamentit, si një nga veprimet më të rëndësishme dhe më afatshkurtra për t'u marrë parasysh.

Në lidhje me kompanitë me zotërim publik, duhet të kemi parasysh se, nëse shohim buxhetin e shtetit, për shkak edhe të disa shërbimeve ekskluzive që i sjellin publikut shqiptar, ato janë kompani të cilat kanë edhe subvencione apo edhe kosto investimi drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

Dua të cek këtu edhe një rekomandim të ardhur nga një dokument i përgatitur nga IDM, me metodologji nga “*Transparency International*”, ku në vlerësimin që i është bërë këtij sektori ka dalë në konkluzionin se të paktën pjesa e financimeve buxhetore, pra ato që vijnë direkt nga buxheti i shtetit, nuk mund të bëhet përmes llogarive në banka të nivelit të dytë, por këto institucione të rëndësishme, të cilat janë shoqëri me zotërim publik, siç e thashë, por nga ana tjetër janë edhe shoqëri të cilat ofrojnë shërbime ekskluzive, si energjetika, uji apo sektorë si portet, duhet t'i bëjnë përmes transaksioneve të thesarit të shtetit. Këtu do të ishte me vend të ndryshohej legjislacioni që rregullon shërbimin e thesarit të shtetit në vendin tonë, po njësoj për kontrollin periodik, auditimin periodik. Kemi një model që i është vënë për detyrë Kontrollit të Lartë të Shtetit të bëjë auditim periodik të njësive të qeverisjes vendore, por mendoj se është me vend ta konsiderojmë edhe për shoqëritë me zotërim publik.

Ju besoj e patë që aty është vendosur edhe një dëshirë për të ndryshuar ligjin për pronarët përfitues. E kemi vënë, sepse kemi referuar që në rastin e Shqipërisë kemi shumë kompani të cilat nuk konkurrojnë përmes tenderave të hapur, por kanë të drejta që vijnë përmes kontraktimeve me ligj apo me rregullime speciale. Nuk po e shoh tani rastin, nëse janë këto të duhurat dhe duhen rishikuar, por mendoj se çdo subjekt, që ka të drejtë të përfitojë financime nga buxheti i shtetit, duhet të jetë transparent për publikun. Ai mund të mos ushtrojë aktivitet në Republikën e Shqipërisë, për pasojë mund të mos jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e pronarëve përfitues. Ky është një ndryshim ligjor i cili duhet bërë shpejt, sepse edhe këto kompani po veprojnë shpejt. Vura re në

progresraportin e fundit se Shqipëria ka vetëm 6, 5% të GDP-së kontraktime të realizuara me prokurim publik gjatë vitit të fundit. Zakonisht, kjo duhet të jetë 9 deri në 10%, çka do të thotë që kemi shumë kontraktime të cilat e kanë kaluar sektorin e prokurimit publik dhe janë kontraktime që vijnë jashtë legjislacionit apo me ligje të tjera dhe jospeciale.

Mirela Miti – Ju lutem, të jemi sa më koncizë të gjithë, sepse dua të marr opinione dhe mendime edhe nga të tjerët! Unë e kuptoj dëshirën e madhe që secili nga ne ka për të dhënë kontribut në këtë tryezë. Njëkohësisht, duke ju kërkuar ndjesë, për të qenë sa më e qartë dhe sa më e hapur me të gjithë, të gjitha mendimet shtruese të mirëdetajuara do t’u lutesha të gjithë pjesëmarrësve të na i adresonin tek adresat tona, me qëllim që ne t’i reflektojmë sa më mirë në raportin tonë final. Të jeni të bindur që ne i kemi studiuar në raportet tona jo vetëm shoqëritë që ju përmendët, por edhe aktorët e tjerë, duke e pasur në formën e një rishikimi literature, siç e quajmë ne, nga pikëpamja e studimeve kërkimore dhe shkencore. Kjo do të thotë që janë mirëtrajtuar të gjithë aktorët dhe të gjitha palët. Është e vërtetë ajo që ju thoni, por do t’ju lutesha, që edhe të tjerët të kenë mundësi për t’u shprehur.

Faleminderit!

Aranita Brahja – Edhe 30 sekonda, jam te fjalja e fundit.

Unë arrita t’i shpreh të katër propozimet që kemi bërë edhe në takimet tona *online* apo fizike, janë mbi 5 të tilla, i kemi depozituar edhe me shkrim pranë 2 adresave të Parlamentit. Në 5 propozime, një ka ngelur pa u angazhuar, por mendoj se është me vend që ai të shkojë te reforma zgjedhore, sepse ka të bëjë me përdorimin e financave publike në periudha zgjedhore.

Në 30 sekondat e fundit dua vetëm të falënderoj ekipin që punoi për Kapitullin V. Kemi qenë një grup ekselent pune, duke filluar nga administrata apo sekretariati teknik, Besarta, profesoreshë Milova, e cila është ulur me ne dhe na ka ndjekur, kolegja tjetër Jolanda, por edhe anëtarët e grupit parlamentar të financave, zonja Milva apo zonja Evis. Kështu që, mendoj se ia kemi dalë të krijojmë edhe një model të mirë të punës jo vetëm ndërsektorial, por edhe me organizata të cilat bëjnë punë *watch dog* apo monitorim dhe ndonjëherë vijnë me ide advokuese shumë të forta.

Mirela Miti – Faleminderit, zonja Brahja!

Mendoj se në të tria shtyllat kryesore është një mendim i bazuar në dokumente dhe fakte...

Aranita Brahja – Më falni, se harrova pjesën më të mirë të grupit, që është Ministria e Financave, të cilën nuk mund ta lija pa e falënderuar!

Mirela Miti – Pikërisht, këtë do të thosha edhe unë tani. Në dijeninë tonë, të ekspertëve që kanë punuar, në të gjithë komponentët përkatës të të tria shtyllave, kanë krijuar një raport i cili me të vërtetë ia vlen të përmendet dhe t'u jepet meritë të gjithë aktorëve që kanë bashkëvepruar dhe dëshirës që ata kanë shprehur në këto raporte, për të identifikuar dhe për të realizuar misione që ky komision i posaçëm parlamentar ka në funksionin e tij.

Tani fjala është për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë. Kush dëshiron të diskutojë në lidhje me çështjet, problematikat apo tezat për diskutim të kësaj tryeze?

Ened Topi – Më falni për ndërhyrjen! Ndoshta është më mirë të paraqesim tezat për diskutim.

Mirela Miti – Ened, u diskutuan, të lutem! T'i lëmë të hapura, janë aty... *(Shkëputje incizimi)*

Po, zoti Hroni.

Sotiraq Hroni – Faleminderit!

Në fakt, po prisja ta merrte fjalën përfaqësuesi i biznesit, por vazhduam me shoqërinë civile.

Është kënaqësi që mora pjesë në këtë takim. Nuk jam ekspert i fushës, le ta them qysh në fillim, por edhe tezat e hedhura për diskutim janë shumë të rëndësishme. Në një farë mase, ne jemi duke punuar në këtë fushë, duke angazhuar ekspertë të jashtëm në fushën e menaxhimit të riskut të institucioneve. Është edhe një grup tjetër më vete që flet për planet e integritetit, në përgjithësi. Ne si organizatë jemi investuar për monitorimin e jashtëm të planeve të integritetit dhe, njëkohësisht, duke ndërtuar instrumente që Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vlerësimit të performancës të investohet edhe në monitorimin e planeve të integritetit në çdo institucion.

Jo më larg se pasnesër, me përfaqësues të kësaj tryeze, me të gjitha ministrinë e linjës, kemi një prezantim nga dy ekspertë të pavarur, për vlerësimin e riskut të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ta shërbyer këtë si model, se si mund të ndodhë një përvojë e tillë, në kuptimin që institucionet janë të hapura për ndryshimin e kulturës së punës dhe për monitorimin nga jashtë të risqeve të integritetit. Kjo është diçka që doja ta thosha.

Sa i përket biznesit, unë nuk e dëgjova, por ndoshta mund të konsiderohet se, për sa i përket integritetit në fushën e biznesit, një nga gjërat më të rëndësishme, që është një nga

përvojat më të mira ndërkombëtare, është hartimi i një plani, paktit të integritetit midis qeverisë dhe biznesit. Unë nuk e di nëse është pjesë e këtij diskutimi. Nuk është shumë e lehtë, nuk bëhet brenda ditës, por realisht është një instrument mjaft i rëndësishëm për të rritur atë që quhet “business compliance”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë mirë. Më vjen mirë që është bërë diskutim në këtë drejtim.

Dua të bëj edhe një koment të shkurtër. Dëgjova me shumë interes fjalën e ekspertëve, të cilët përdorin evidenca nga institucione ndërkombëtare, por më duket se ka më shumë evidenca nga institucionet vendore. Përdorimi i këtyre evidencave, referimi i evidencave të ndryshme dhe gjetjeve të ndryshme të raporteve vendore janë shumë të rëndësishme dhe i bëjnë mirë të gjithë shoqërisë, në kuptimin që jo gjithçka që na thonë të huajt, për aq kohë sa në raportet për Shqipërinë GRECO u referohet evidencave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Pra, duhet të kemi parasysh që përdorimi, njëkohësisht edhe evidentimi, i gjetjeve dhe i punës së organizatës së shoqërisë civile mendoj se janë shumë të rëndësishme. Dua të sjell këtu edhe një shembull, të cilin e kam thënë edhe herë të tjera, por, meqenëse m’u dha rasti nuk kam ndërmend ta përmend përsëri. Zonja Gjonaj, kur ka qenë ministre e Shëndetësisë, planet e integritetit janë bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ministre e Drejtësisë!

Mund të jetë e para, ndoshta edhe e vetmja, gjithmonë në dijeninë time, që, si autoritet i një institucioni publik, siç është Ministria e Drejtësisë, beson tek ekspertiza ndërkombëtare aq sa tek ekspertiza vendase. E gjithë kjo punë me planet e integritetit, qoftë në nivel vendor, qoftë në nivel kombëtar, nuk do të ishte bërë, nëse zonja Gjonaj nuk do të kishte fuqizuar një organizatë të shoqërisë civile për t’u marrë me këtë gjë. Nuk ndodh shpesh, por është diçka shumë e rëndësishme, sepse unë mendoj që ekspertiza vendase është në nivelin më të lartë të mundshëm, sepse, në fund të fundit, edhe ndërkombëtarët investohen ose e bëjnë shumicën e punës së tyre prej ekspertizës vendase.

Shumë faleminderit dhe kënaqësi që mora pjesë!

Mirela Miti – Faleminderit, zoti Hroni!

Nëse dikush tjetër do të flasë në lidhje me integritetin.

Esmeralda Hoxha – Thjesht doja të flisja pak për pjesën e angazhimit të ekspertëve të jashtëm, bazuar edhe në fjalën, diskutimet apo komentet shumë të vlefshme të zotit Hroni.

Mirela Miti – Jo, të lutem, sepse dua të shprehen të gjithë pjesëmarrësit! I diskutove çështjet dhe në këtë moment kam interesin që pjesëmarrësit të japin opinionet e tyre në lidhje me diskutimet.

Esmeralda Hoxha – Faleminderit!

Unë jam Esmeralda Hoxha nga qendra “Aleanca gjinore për zhvillim”. Ju falënderoj shumë që na keni bërë pjesë të kësaj tryeze sot! I gjej me shumë vlerë çështjet që ju keni listuar për t’i zgjidhur. Unë do të doja të ndalesha vetëm në një pikë, pa u zgjatur.

Pak më parë ekspertja, profesoreshë Milova, citoi që buxhetimi i përgjithshëm gjinor është integruar në të gjitha programet e buxhetit të qeverisë shqiptare, përfshirë këtu edhe ai integrim që është bërë në buxhetet e pushtetit vendor. Ajo që ne shohim, si shoqëri civile, që është tip *watch dog, monitoring*, advokaci për grupe të ndryshme, është se nuk arrijmë t’i gjejmë. Janë patjetër në letër, janë të integruara, por si janë buxhetuar, si janë kostuar dhe a po implementohen ato realisht në terren?

Faleminderit shumë!

E ftuar – Përshëndetje!

Atëherë, ne i jemi referuar raportit të monitorimit të strategjisë nga Ministria e Financave për informacionet që kemi atje, po gjithsesi do ta shohim më të detajuar, për ta paraqitur te materiali përfundimtar.

Faleminderit!

Mirela Miti - A ka diskutime të tjera?

Dëshira Mema - Unë quhem Dëshira Mema, vij nga shoqëria civile, Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë.

Ne si shoqëri civile jemi përfshirë shumë në nismat ligjore që në momentin që në Parlament është diskutuar një projektligj, i cili na prek në mënyrë të drejtpërdrejtë ne, si grupim civil, që ka të bëjë, pikërisht, me inxhinierinë shqiptare, kryesisht me projektligjin që ka të bëjë me Urdhrin e Inxhinierit. Do ta marr shembull jo për të shpërqendruar vëmendjen e komisionit, por për të ilustruar se si ndikohet dhe infiltrohet një projektligj dhe një iniciativë ligjore në jetën e shoqërisë civile dhe në jetën e grupeve të interesit. Aktualisht, ky projektligj, që po diskutohet në komisionet parlamentare, në fakt, janë dy projektligje të tilla, të cilët kanë dy vjet që

diskutohen dhe janë pjesë e agjendës së komisioneve parlamentare, por nuk kanë marrë një drejtim të caktuar, ndonëse e gjithë shoqëria civile ka dhënë argumentet e saj dhe është bërë pjesë aktive e këtij procesi, për të ndikuar në marrjen e një vendimi të caktuar në lidhje me këto dy projektligje, që është refuzimi i tyre, pasi aktualisht profesioni i inxhinierit është një profesion i rregulluar me ligj.

Këtu dal tek tema që ka të bëjë me sundimin e ligjit, që është pika e tretë e këtij diskutimi. Pra, ndërkohë që ne kemi ligje të rregulluara për profesionin e inxhinierit, dalin në tavolinë dhe diskutohen projektligje paralele, që mbivendosin shërbimet e kësaj kategorie, mendoj se kjo gjë mund të mos jetë rastësore, mund të mos ndodhë vetëm në rastin tonë, ne këtë kemi kapur, sepse jemi grup interesi dhe merremi në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë gjë, por mund të këtë edhe plot ligje të tjera, që kanë mbivendosje të tyre dhe një devijim të rregullimit të fushës përkatëse.

Aktualisht, në mënyrë konkrete për këtë projektligj, i cili po diskutohet, Ministria e Drejtësisë është shprehur në mënyrë specifike: projektligji i propozuar cenon të drejtën e sigurisë juridike. Pra, diskutohet dy vjet e gjysmë në Parlament, harxhohet koha e të gjitha grupeve të interesit, e komisionerëve, e atyre që kanë propozuar për një kohë kaq të gjatë për një projektligj, i cili aktualisht është një mbivendosje e ligjeve aktuale, kjo jo vetëm që nuk ka të bëjë me eficiencën e punës së Parlamentit, jo vetëm që nuk ka të bëjë me transparencën, por tregon edhe një mungesë vullneti për të zgjidhur gjërat në momentin e duhur. Unë mendoj se qëllimi kryesor dhe iniciativa kryesore është sundimi i ligjit, pra sundimi i ligjit ashtu siç është shkruar dhe aprovuar, dhe të mos të bëjmë mbivendosje të ligjeve, për të krijuar situata pastaj jo korrekte dhe jo të drejta.

Gjithashtu, një pikë tjetër, që ne e vëmë re në jetën tonë të përditshme, nuk është shumë mungesa e ligjit, por mungesa e zbatimit të ligjit. Në aktivitetin tonë të përditshëm, inxhinieria është një kamp shumë i rëndësishëm, gjithçka që ju diskutoni ka lidhje me inxhinierinë, çdo punë publike, çdo aktivitet, 70% e ekonomisë së vendit ka lidhje me inxhinierinë, ne jemi çdo ditë ai sektor i ekonomisë që merret me tendera pa fund, me menaxhim fondesh publike pa fund. Pra, e gjithë ekonomia e vendit rrotullohet rreth punëve inxhinierike. Antikorrupsioni ka të bëjë pikërisht me menaxhimin e këtyre fondeve publike, të cilat adresohen dhe menaxhohen nëpërmjet inxhinierisë. Ligjet janë shumë të mira shpeshherë, por nuk zbatohen. Çfarë ndodh kur nuk zbatohen ato ligje? Jepen lejet e ndërtimit për objekte të ndryshme, ndërkohë që të gjitha

pikat që duhet të ketë një dosje për leje nuk zbatohen në mënyrë rigoroze. Atëherë, çfarë ndodh në këtë pikë? A ka sektorë, apo ka ligje, apo ka amendamente, të cilat kontrollojnë punën e institucioneve? Kjo është një pikë shumë e rëndësishme, për t'i prerë rrugën abuzimit për menaxhimin e fondeve publike brenda institucioneve. Ai institucion, që menaxhon fonde publike, nuk është i zoti i atyre fondeve publike, ai është thjesht një menaxher, që duhet të bëjë detyrën e tij në mënyrën më të mirë të mundshme dhe kaq.

Dy janë pikat kryesore të cilat ne i ndiejmë në punën tonë të përditshme, e para është krijimi i ligjeve, të cilat mbivendosen mbi ligjet ekzistuese, duke krijuar devijime për rregullimin e profesioneve të ndryshme, në rastin tonë, për profesionin e inxhinierit, dhe e dyta është mungesa e zbatimit të ligjeve në sektorët publikë, e cila bëhet shpeshherë pengesë për menaxhimin e drejtë të këtyre fondeve.

Mirela Miti – Faleminderit!

Ju lutem, një parantezë për të gjithë pjesëmarrësit: të mos shpërqendrohemi nga fokusi kryesor i kësaj tryeze, që në rastin konkret ka të bëjë pikërisht me eficiencën e institucioneve që luftojnë korrupsionin, por në drejtim të menaxhimit të fondeve publike.

Kështu që, unë po e rikthej pak vëmendjen te prezantimi që bëri Eneidi, unë personalisht jam pjesë e grupit të ekspertëve, që ka të bëjë me një çështje, që është shumë për t'u diskutuar, unë shoh në këtë panel pjesëmarrës të fushës, ku do të doja patjetër mendimin e tyre. Ka të bëjë me rekomandimet që ka lënë Komisioni Europian në vite, që njëkohësisht është një punë e palodhur e të gjitha institucioneve të vendit në drejtim të zbatueshmërisë së tyre. Por përsëri, po të shikohen treguesit, nga raportet respektive, identifikohet një tregues, që ka të bëjë përkatësisht me zbatueshmërinë e rekomandimeve që vendosen dhe që jepen gjatë raporteve të audituesve, në të dyja këndvështrimet: audituesi i brendshëm brenda institucionit, apo audituesi i jashtëm, i cili realizohet nga KLSH-ja.

Pra, efektshmëria e zbatueshmërisë së rekomandimeve që vendosin audituesit është një çështje për t'u diskutuar. Në këtë këndvështrim, do t'ju lutesha pjesëmarrësve të diskutojnë në lidhje me to. Ne kemi rekomanduar disa elemente, që lidhen me bordet e mbikëqyrjes.

Së pari, kemi të bëjmë me një menaxhim të fondeve publike, të cilat auditohen, dhe në krahun tjetër kemi efektshmërinë e tyre. Si mundemi të realizojmë një mekanizëm, ku zbatueshmëria e këtyre opinioneve të lëshuara mbi bazën e raporteve të jetë efektive?

Nga ana tjetër, kemi diskutuar dhe hedhur për diskutim krijimin e një bordi mbikëqyrës. Në zbatim të rekomandimeve të BE-së është krijuar nënkomisioni parlamentar në lidhje me monitorimin dhe zbatueshmërinë, që ka qëllim zbatueshmërinë e opinioneve dhe rekomandimeve që vendos KLSH-ja. Çështja për diskutim në këtë rast do të jetë: a mundet që ky nënkomision, i përbërë me 3, 4, 5 veta të jetë aq efektiv, sa të realizojë impaktin, sepse impakti i auditimit është thelbësor në menaxhimin e fondeve publike? Prandaj, në këto drejtime unë do të doja ta fokusoja tani këtë diskutim.

Faleminderit!

Përkthyes - Dëgjova të gjitha kontributet e ekspertëve në këtë fushë dhe do të doja të ngrija disa çështje në lidhje me rolin e auditimit të jashtëm dhe rolin e Parlamentit në rritjen e impaktit të rekomandimeve të auditimit, kur vjen puna për një mbikëqyrje më të fortë për shpenzimet publike, por edhe më gjerë, në përdorimin e burimeve publike.

Së bashku me institucionet e ndryshme kemi punuar për krijimin e një nënkomiteti të tillë në sektorin publik. Me sa duket ky nënkomitet është një çështje shumë e rëndësishme, pra nënkomiteti është tamam organi i duhur, i përshtatshëm, që të luajë këtë rol, ose duhet të jetë i gjithë komisioni, pra në kuptimin që kur ne shikojmë kompetencat e nënkomiteteve, përkundrejt se çfarë duhet të bëjnë nga kontrolli i post apo ekspost, apo vlerësimi përkundrejt punës *ex ante* dhe punës që kryhet nga një komision për ekonominë dhe financat.

Gjithsesi, për shkak të momentit politik dhe kohës së shkurtër për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ndoshta duhet të ketë edhe një strukturë më të fortë të strukturave parlamentare, të cilat janë ndryshuar këto vitet e fundit, gjithashtu, mbështet edhe nënkomiteti i këtij komisioni me detyrën e ngarkuar.

Kur flitet për rolin dhe rritjen e efikasitetit, efektivitetit, rregullshmërisë dhe rekomandimeve që vijnë nga KLSH-ja, unë mendoj, nga perspektiva jonë, se është shumë e rëndësishme të vihet theksi te fakti që këto organe parlamentare nuk punojnë të izoluara nga organet e tjera.

Roli i nënkomisionit dhe roli i KLSH-së është që të kenë marrëdhënie pune, të punojnë në partneritet kurdoherë që organe të tilla ekzistojnë, pavarësisht nëse janë nënkomisione apo komisione, këto organe mbështeten tek ekspertiza e KLSH-së e ekspertëve të KLSH-së. Në Shqipëri ne shikojmë se këto marrëdhënie mund të kishin qenë shumë më funksionale dhe të mbështesin rolin në Parlament të mbikëqyrjes së shpenzimeve publike. Numri i anëtarëve të

komisionit mendoj se është më pak i rëndësishëm, mund të jenë 5, 7 apo më shumë, për këtë mund të merren dhe praktikat ndërkombëtare, por ajo që është më e rëndësishme janë kompetencat e këtij organi, gjithashtu edhe ekspertiza që ky organ ka për të ofruar mbështetje cilësore për mbikëqyrjen e ekonomisë, ligjshmërisë së raporteve të auditimit.

Ne kemi shembuj të tillë të ngjashëm edhe në rajon. Në Kosovë ekziston një komision i tillë, i plotë, për më shumë se 10 vjet, kështu që nuk duhet të shkojmë përtej rajonit, pra mund të marrim shembuj edhe këtu në rajon dhe modele të tilla kanë provuar të jenë efikase dhe efektive. Por, gjithsesi, kurdoherë që shikoni sukses të organeve të tilla, kjo varet edhe nga mbështetja që Parlamenti u ofron organeve të tilla, pra mbështetja administrative, nëpërmjet stafit të komisioneve.

Parlamenti në Shqipëri, gjithashtu, ka edhe Shërbimin e Monitorimit, si një institucion të pavarur. Pra, është kjo lloj ekspertize, që ofrohet, dhe unë do të doja të theksoja edhe këtë marrëdhënie partneriteti midis ekspertëve dhe ekspertëve të KLSH-së. Nëse kemi parlamente me burime më të mira, më të shumta, shikoni, për shembull, në Poloni, në Gjermani, në Britaninë e Madhe, në Danimarkë, apo në parlamente të tjera, mbështetja tek ekspertiza e audituesve të jashtëm, që duhet t'i ofrojnë mbështetja parlamentit përpara takimeve zyrtare, apo që u bëjnë përmbledhje të shkurtra, ofrojnë ekspertizë, atëherë suksesi i këtyre organeve varet vërtet nga këto, dhe jo vetëm këto komisione nëpërmjet organizimit të seancave të dëgjësive publike, por edhe njësive buxhetore, të cilat janë pjesë e diskutimeve dhe që mbështeten, gjithashtu, edhe në ekspertizën e shoqërisë civile dhe të botës akademike në tërësi.

Besoj ky do të jetë një hap i mëtijshëm në këtë drejtim. Nënkomisioni është krijuar tashmë prej disa muajsh, dhe ia vlen që të shikojmë strukturën mbështetëse që ka ky nënkomision, me qëllim që të ofrohet një impakt i dëshiruar në rritje për zbatimin e rekomandimeve.

Gjëja e fundit që do të doja të thosha: kur shikojmë marrëdhëniet midis KLSH-së dhe Parlamentit, shumica e fokusit është te dy raportet çdo vit, njëri është raporti i performacës, që diskutohet një herë në vit dhe raporti apo dokumenti tjetër është raporti për rishikimin e ekzekutimit të realizimit të shpenzimeve buxhetore.

Besoj se këto janë shumë të rëndësishme dhe duhen parë edhe në fusha të tjera të përdorimit të burimeve publike, të cilat në njëfarë mënyre nuk janë marrë mirë parasysh. Pra, ky nënkomision duhet të jetë në gjendje që t'i shikojë edhe këto raporte të tjera dhe rregullisht të

japë llogari, të bëjë prezantime para Parlamentit, pastaj të kërkohet që të bëhen raportime periodike në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, që janë nxjerrë jo vetëm nga KLSH-ja, por edhe nga komisioni parlamentar.

Faleminderit!

Mirela Miti - Zoti Brumbulli, Fjala për ju. Unë do të doja t'ju thërrisja profesor.

Spiro Brumbulli - Faleminderit!

Unë, përfaqësoj shoqatën e bankave.

Faleminderit për këtë takim! Shumë faleminderit dhe përgëzime raportuesve për çka paraqitën!

Në fakt, nga paraqitja të krijohet ideja se kemi të bëjmë me një kuadër legjislativ, rregullativ të plotë, jo të dhënë, të rishikuar ndër vite. Në kuadër të përafrimit tani me legjislacionin e BE-së, duket sikur me këtë temë që po diskutojmë jemi shumë afër asaj që edhe BE-ja ka si standard, me rregullime të vogla.

Një vërejtje shumë shoqërore do të doja të bëja në referimet që dëgjova, është të zbutet pak gjuha, sepse duket sikur i gjithë synimi për rregullimin ligjor është masa shtrënguese, dënime e të tjera. Nuk është ky qëllimi. Edhe në kuadrin rregullues, ne i kemi të gjitha këto masa dhe nuk është se kanë bërë ndonjë efekt, thjesht në vetvete, duke përmendur masën ndëshkuese.

Së dyti, duke përmendur dhe theksuar vetëm masat ndëshkuese, të mos trembim edhe njerëzit që do t'i marrin këto detyra përsipër, sepse ne shumë mirë që e kemi evidentuar që jemi në krizë njerëzish, domethënë, ekspertësh, personalitetesh dhe na mungojnë jo vetëm në administratën publike, por edhe në sektorin privat. Kështu që, do të doja më shumë t'u referohemi standardeve dhe praktikave më të mira. Standardi vetë ka edhe masën shtrënguese, por është standardi që përcakton, është praktika më e mirë që duhet të marrim.

Në këtë aspekt unë kam për të thënë, dhe ajo që më tërhoqi vëmendjen edhe nga rastet e përmendura, është që ju evidentoni shumë gjëra, por keni lënë jashtë vëmendjes një ligj, që është shumë i rëndësishëm, që prek financat edhe publike, dhe nga eksperiencia që kam pasur në Ministrinë e Financave, ligji për shërbimin civil. Ne fillojmë aq shumë projekte dhe aq shumë reforma, se po të shikosh në fillim të një projekti apo të një reforme, kemi një staf të caktuar, dhe në fund kemi një staf krejt tjetër. Dhe kjo ka ndodhur gjatë këtyre 30 vjetëve, nuk është fenomen i sotëm. Pra, nëse ne nuk do të arrijmë të sigurojmë qëndrueshmëri në stafe dhe në ekspertë, sado ligje të mira të bëjmë, sado ne të vendosim këtu matrica me afate, ne përsëri nuk do të jemi

efektivë. Pra, ju me të drejtë theksoni se nuk është vetëm problemi i hartimit, por edhe i efektivitetit të zbatimit të ligjit. Me ato që unë njoh rreth ministrive, administratës publike, veçanërisht Ministrisë së Financave, kanë ndodhur ndër vite ndryshime shumë të madha. Ne kemi humbur ekspertë shumë të mirë, për një arsye ose një tjetër, ndërkohë që gabimet e personave të caktuar kanë krijuar gropë buxhetit të shtetit. Për shembull, vetëm me heqjet e pajustificuara nga vendi i punës, që nga 2005-sa deri në 2013-ën, kur unë shkova në ministri, ishin miliarda lekë që u paguan. Po kështu, ka edhe tani procese gjyqësore që janë me gjoba. Këto nuk janë faj i mungesës së legjislacionit, këto janë përgjegjësi e atyre që kanë të drejtën e vendimmarrjes apo procesit të kontrollit të brendshëm nëpër institucione. Sa do të vazhdojmë ne me këtë metodë?

Ju përmendët ndërmarrjet shtetërore, unë nuk jam dakord që ndërmarrjet shtetërore të kalojnë nga thesari, sepse ato janë njësi ekonomike tregtare, ndryshon vetëm pronësia, por ato duhet të jenë. Në kuadër të auditimit, ato auditohen të gjitha llogaritë, qoftë në një bankë apo qofshin në 1 mijë banka, dhe nuk është vështirësia atje. Për shembull, në ndërmarrjet shtetërore pse ne duhet të jemi kaq joefektivë dhe me humbje? Çfarë ndodh? Pse ndërmarrjet private ne i kemi me fitim dhe ndërmarrjet shtetërore janë gjithmonë me humbje? Shikoni vetëm një gjë, shikoni vetëm mënyrën e emërimit dhe të ndryshimit të stafeve drejtuese në këto ndërmarrje shtetërore. Vini njerëz pa asnjë *background*. I kam ndjekur edhe për kuriozitet shkencor, për veten time, të gjitha ndryshimet që janë bërë. Janë vendosur njerëz që nuk kanë haberin e sektorit ku shkojnë, nuk kanë një plan, ku do ta marrë sektor, çfarë problemesh ka dhe ku do ta çojë. Ndodh që, edhe pse ka qenë në një gjendje të mirë, po e quaj, ndërmarrja, me heqjen e një stafi drejtues dhe me emërimin e një stafi tjetër, se është ndërruar ministri, ka shkuar dhe më keq dhe askush nuk bën analizë. Askush nuk bën analizë.

Këto janë probleme, që ne duhet t'i evidentojmë realisht. Unë shikoj që ju këmbëngulni te strukturat, unë them që kemi mjaft struktura, nuk na duhen më struktura. Madje nuk i kisha parasysh të gjitha ato që u parashtruan, por kur i pashë thashë me vete: ne jemi të mbushur më shumë me struktura, që mbase nuk na duhen, dhe me gjithë këto struktura ne prapë nuk jemi efektivë. Për mua i gjithë perceptimi i korrupsionit, që ka ardhur dhe ka mbushur opinionin publik, dhe nuk e durojmë dot më, janë nga prokurimet publike dhe nga PPP-të. Pse janë? Sepse ka mungesë transparence.

Këtu u theksua pak transparenca, se çfarë duhet të bëjmë. Pa transparencë nuk ka as kontroll, as auditim, as vendimmarrje për ta rregulluar situatën. Jam shumë dakord që të ndahet auditimi. Kjo është gjetje me vend, dhe jam plotësisht dakord dhe tek angazhimi i ekspertëve të jashtëm. Ne në sektorin privat kemi një kontroll, që e ka drejtori levë të veten, që duhet edhe për operacionet e përditshme të marrë informacion apo të informohet se si shkon në një sektor të caktuar, por kemi auditimin tjetër, që varet nga bordi, pra është i pavarur nga ekzekutivi, nuk jep llogari tek ekzekutivi, jep te bordi, dhe për auditimin e pasqyrave financiare janë ekspertët e jashtëm, është një tjetër kompani që e bën, që nuk ka lidhje fare as me bordin, as me kompaninë. Pra, angazhimi i ekspertëve të jashtëm është vlerë e shtuar, nuk është vlerë e munguar.

Por unë shikoj se ka dy standarde, edhe pse dalin çështje brenda për brenda, ato shkojnë tek titullari. Po u mbyll cikli brenda për brenda, sigurisht që nuk ka masa, nuk ka përmirësim. Pra, ato duhen shkëputur. Vendimmarrja është tjetër gjë, ekzekutivi, tjetër gjë është auditimi dhe mënyra se ku duhet të raportojë. Ndoshta mund të jetë nën Këshillin e Ministrave, ishte propozim, kjo ndoshta duhet parë.

Nga pikëpamja e ekzekutivit Këshilli i Ministrave është qeveria, është trupi, nuk kemi bord të themi mbi ministrin, kemi qeverinë dhe ndoshta mund të jetë atje ai, mund të jetë një zëvendësministër, që merret me të gjitha këto dhe që i raportohen, por është shumë e rëndësishme që të raportohen. Ne nuk vuajmë që të themi se nuk e kemi të përcaktuar me ligj që të mos bëhen ndryshime të buxhetit, por tani jemi mësuar, gati çdo vit bëhen 3-4 ndryshime, akte normative. Po kjo nuk është disiplinë buxhetore, e di shumë mirë se çfarë heq Ministria e Financave.

Unë jam dakord me hartimin e planit të Ministrisë së Financave, që buxheti duhet të jetë programor, duhet të ketë program zhvillimi. Pra, duhet të marrim disa sektorë për tre vjet dhe t'i mbarojmë, por ne kemi 30 vjet që merremi me rrugët dhe nuk mbarojnë, kemi mbi 10 vjet me një rrugën atë të Qafë Plloçës, dhe nuk po e mbarojnë. Ndërkohë që po hapim segmente të tjera, që Shqipërisë i duhen, por, nëse i duhen, le të përqendrohemi 5-6 vjet, të bëjmë akset kryesore, dakord, të kemi fikusin atje dhe pastaj të merremi me të tjera, se 30 vjet nuk mund të vazhdojmë ta lëmë arsimin në këtë gjendje, nuk mund ta lëmë shëndetësinë në këtë gjendje.

E di shumë mirë Ministria e Financave se çfarë heq kur duhet të caktojë fonde, dhe kur duhet t'u plotësojë kërkesat ministrive përkatëse, jo sepse është prioritet gjithmonë infrastruktura. Nuk na mungon nga ligji, është edhe çështje vullneti, është edhe vullneti politik,

është edhe qeverisja e vendit, janë pastaj edhe ato detyra që vendos Parlamenti, në fund të fundit, për të ushtruar rolin e vet.

Unë një gjë nuk gjej dot, një mekanizëm, këtë që ju përmendni, për të luftuar korrupsionin te financat publike, sidomos të tenderat dhe PPP-të, se Ministria e Financave nuk ka tjetër se çfarë të bëjë. Ata kanë fondet, fondet i kanë ministritë. Nëse ministria apo Agjencia e Prokurimit Publik bën tenderin dhe ai jep filanit, ministria është e detyruar ta zbatojë, se ka disiplinë, ka ligj, nuk mund t'i ndalojë dot fondet që të mos rrjedhin, sepse në perceptimin popullor është e tillë: çfarë bën ministria, pse ia jep fondet atij, paratë atij? Por ka kontrata. Pastaj ndodhemi edhe më keq, se marrim dhe penaltete për kontrata, që është më keq nga këto. Por si do ta bëjmë? Ka një program, që është lançuar, mbi kompjuterizimin e prokurimeve publike. Shumë mirë, sa më pak punë njerëzore, por duhet më shumë transparencë dhe sa më pak ndërhyrje. Këtë të ndërhyrjeve, të them të drejtën, unë nuk kam ilaç që ta them sot, sepse ndërhyrjet janë që tek emërimet, që te fitimi i tenderave. Të paktën në 30 vjet këtë punë kemi bërë, ka shumë biznese të pakënaqura, që thotë :hymë në tender, u anulua tenderi, më skualifikoi për këtë dokument, se duhet bërë tenderi tjetër, që t'i jepet këtij, ose u ndryshua ky udhëzim apo kjo rregullore, se duhet të bëhet iks drejtues.

Këto nuk janë gjëra pozitive dhe këto janë edhe vullnet politik, gjë që ne nuk e matim dot në këtë që ju raportuat, por ka të bëjë shumë në atë që ne duam të realizojmë. Po mirë, kur ndodhin të gjitha, këto kush i kontrollon këto? A kemi ne një mekanizëm, që të ketë frikë edhe ministri, dhe Agjencia e Prokurimit Publik, apo të gjithë këto, që marrim vendime që, nëse bëjnë një ndryshim të tillë, ia heqin iksit, për t'ia dhënë ipsilonit, të jenë të frikësuar, në kuptim që dikush tjetër do të vijë t'i kontrollojë dhe raporti i tij do të raportohet diku që është i pavarur? Këtë nuk e kemi. Prandaj, ne mungojmë, se kemi gropa të hapura dhe kemi cikle të mbyllura. Nëse nuk do të hapim ciklin, të krijojmë pavarësinë, që atje ku kontrollohet të mos raportohet, por të raportohet në një organ tjetër, më lart, të pavarur nga objekti që kontrollohet, sigurisht që jemi brenda ciklit dhe gjërat vijnë vërdallë.

Mund të kem dhe gjëra të tjera për të thënë, por po ua lë minutazhin dhe kolegëve të tjerë.
Faleminderit!

Mirela Miti - Po zoti Dhamo, do të doja t'ju thosha profesor.

Sotiraq Dhamo - Nuk ka problem, se tani profesorët janë bërë me thasë në Shqipëri, kështu më mirë me emër, se emri është personal.

Faleminderit për ftesën!

Së pari, doja t'u përgëzoja për këtë rishikim literature, shumë të thelluar që keni bërë, sepse pa studiuar se çfarë ekziston, është e vështirë të japësh rekomandime. Nëse duhet të diskutojmë se çfarë ndodh në Shqipëri, pse ndodh, duhet të rrimë secili nga 2 orë dhe të jenë pak. Kështu që, unë do të përpiqem të përqendrohem pak a shumë ku ju jeni përqendruar.

Pra, çështja që shtrohet është si të luftohet korrupsioni? Korrupsioni është një çështje e njeriut dhe çështje vullneti, së pari, pra do apo jo të bëjë korrupsion një person dhe, e dyta, nëse legjislacioni ia lejon ta bëjë, apo i krijon kushte ta bëjë, ose dhe kur e bën, nuk e kontrollon, nuk ka mundësi që ta gjejë. Këto janë pika që duhen rregulluar.

Prandaj, unë them që në materialin tuaj duhet të shikohet më shumë thelbi te rritja e kapaciteteve njerëzore, dhe kjo lidhet edhe me atë që tha zoti Brumbulli përpara. Pra, duhet të kemi njerëz të aftë, të përgatitur që të realizojnë këtë dhe duhet që t'u japim garanci për atë që bëjnë që, nëse zbatojnë ligjin, të mos kenë frikë nga askush që mund të lëvizin. Pra, të bëjmë atë që në shumë vende të zhvilluara sot ekziston, që niveli i caktuar i administratës, sado të ndryshojë drejtimi politik i një vendi, nuk preket. Kjo siguron vazhdimësinë edhe në investimet që bëhen, sepse është e qartë që investohet te njerëzit, por investon qeveria dhe pastaj shkojnë jashtë, dhe japin efektivitetin në një vend tjetër.

Unë mendoj, gjithashtu, që në lidhje me problemin që shtroni për KLSH-në, ligji lejon që institucionet, organizata publike ta japin *outsorc* shërbimin, por nuk e di sa duhet të jetë e mundur që rekomandimet e këtyre audituesve të jashtëm të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar, ndërkohë që rekomandimet e KLSH-së nuk e di ku shkojnë.

Pra, çfarë ndodh në Shqipëri? Kemi një ligj që KLSH-së i jep të drejtën të vendosë, të bëjë auditime performance, financiare. Ajo është pika e kontrollit financiar, në fund të fundit, që kemi ne. Pika më e fortë ajo është; ne themi sa të duash për auditimin e brendshëm, ky është auditimi i jashtëm, që është jashtë konfliktit të interesave me ata që japin urdhra për menaxhimin e financave. Rekomandimet e tyre çdo vit dalin me miliarda e miliarda dhe askund nuk i shikojmë. A janë me të vërtetë, apo jo? Çfarë bën kjo? Humbet besueshmërinë te shifra që nxjerr dhe punën që bën KLSH-ja, si dhe i lejon ata që duan të bëjnë korrupsion t'i zbatojnë, sepse thonë: hajt se KLSH-ja flet kot.

Atëherë, çfarë duhet të mendoj unë që të forcohet rekomandimi që keni ju? Të gjendet një mënyrë që, përveç asaj që KLSH-ja të ketë një bord monitorues për financat publike në Kuvend,

të rregullohet ligji dhe gjetjet që bën KLSH-ja të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar, ose të paktën për t'u hetuar. Pastaj, nëse do të hetohen, organi investigues nuk mund t'i anashkalojë, sepse bëhet përgjegjësia dyshe: edhe ky që e nxjerr, nëse gënjen, edhe ky që e heton, nëse gënjen. Pra, të gjitha vendimet dhe të gjitha gjetjet e KLSH-së të jenë të detyrueshme për t'u hetuar, jo a mundet që KLSH-ja të bëjë denoncim në prokurori, apo jo. Duhet gjetur një rrugë, nuk po them se cila është rruga më e mirë, se si duhet, sepse do të pretendoja shumë, por të paktën nëse e pranojmë në parim këtë, rruga gjendet.

Shoh që keni përmendur digjitalizimin, unë mendoj se është momenti të futet në strategjinë e qeverisë, që të krijohet një platformë unike, pra jo të shkëmbejnë institucionet, sepse ngelet në dëshirën e tyre, duan, ta japin, nuk duan, nuk ta japin, por të jetë një databazë e unifikuar, ku çdo institucion të futet e të marrë atë që do, sipas aksesëve që ua lejon ligj. Për shembull, është një pikë atje, që mua më bëri shumë përshtypje, me të cilën nuk do të isha kurrë dakord: marrëveshje e KLSH-së me Ministrinë e Financave. Si mundet që institucione, pjesë të të njëjtit shtet, bëjnë marrëveshje bashkëpunimi me njëra-tjetrën? Është e paimagjinueshme ta mendoj, mund ta bëjnë me shoqërinë civile, por jo me sektorë të së njëjtës pjesë. Për shembull, bëjnë marrëveshje Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Doganën, janë e njëjta gjë. Pra, nëse duam të shkëmbejmë informacion, ne duhet të investojmë në këtë platformën unike. Shtetet e qëndrueshme kanë një platformë, ku futen dhe shumë gjëra i zgjidhin atje, marrin informacion atje, kjo siguron që, nëpërmjet inteligjencës artificiale, të bëjnë ato kryqëzimet: si e ka njëra, si e ka tjetra, pastaj dalin edhe diferencat, të cilat mund të luftohen.

Unë mendoj se një gjë, që është shumë e rëndësishme: ligje kemi, por shpesh nuk zbatohen për disa arsye, sepse ligji duhet të shoqërohet me një akt sqarues, me një akt nënligjor, që janë udhëzime, por edhe kur ka institucione, shoqëri, ndërmarrje, që duan ta zbatojnë ligjin, ose kur i drejtohen atij institucioni, që interpretues apo sqarues, nuk e gjejnë.

Kam këtu mikun tim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilës i kërkon sqarim për një çështje të caktuar dhe të përgjigjet: kështu e kemi në udhëzim. Ne udhëzimin e dimë, por udhëzimi nuk është i qartë. Atëherë, çfarë ndodh? Ai që kontrollon këtë ligj, e interpreton si të dojë, ai që e zbaton, e interpreton ashtu si di apo si do, pastaj vjen puna tek ato aktet korruptive, me inspektorin përkatës, me atë që ka shkelur me apo pa dëshirë ligjin.

Korrupsioni po u shtri në këtë nivel, është si puna e kancerit, pastaj, që nuk hiqet dot. Unë gjykoj se, pikërisht, këtu është pika e korrupsionit në Shqipëri, është përfshirë jo lart, sepse

populli ka thënë që peshkut që qelbet koka, i pritët dhe shpëton, e ha me një fjalë, por këtu ka shkuar te bishti, ndaj duhet të shohim si të luftojmë që njerëzit e zakonshëm, inspektorët e niveleve të ulëta apo nëpunësit e niveleve të ulëta të mos e bëjnë korrupsionin. Kjo bëhet, e para, duke edukuar dhe, e dyta, duke dhënë siguri për vendin e punës, pastaj duke e kontrolluar.

Unë gjykoj se është e nevojshme që të bëhet rishikimi i legjislacionit, sepse ka shumë ligje që nuk janë në harmoni me njëri-tjetrin, duhet të harmonizohet legjislacioni, e them këtë jo në parim, por sepse një legjislacion i harmonizuar siguron mundësinë e zbatimit nga ata që duan ta zbatojnë mirë dhe nga ata që duan ta kontrollojnë mirë.

Unë jam dakord me atë gjetjen tuaj, që u tha këtu, në lidhje me forcimin e rolit të Kuvendit për ekzekutivin. Pra, është si puna e një shoqërie private, ku kemi drejtorin ekzekutiv, kemi edhe bordin. Parlamenti është bordi, kurse qeveria është drejtori ekzekutiv, kur them qeveria, e kam fjalën për të gjitha hallkat e qeverisë. Kështu që, duhet të gjenden mënyra që të mbikëqyret sa më shumë nga Kuvendi puna e institucioneve, sidomos e këtyre institucioneve që lidhen me pjesën financiare, me përdorimin e burimeve financiare, sepse, në fund të fundit, korrupsioni bëhet atje ku ka para, aty lind. Kështu, ata që kanë mundësi t'i përdorin mjetet monetare, fondet të jenë të kontrolluar. Sigurisht, këtu flitet për audituesit e brendshëm, nuk duhet të varen nga drejtuesit.

Ne që merremi me këtë punë, e dimë të gjithë që audituesit e brendshëm janë strukturë e drejtimit të ekzekutivit, ata thonë se si duhet të kontrollojnë, sepse ata delegojnë dhe duhet të kontrollojnë atë që kanë deleguar. Janë audituesit e jashtëm ata që kontrollojnë se si ky drejtor po i përdor fondet në përputhje me interesin e publikut. Në këtë kontekst, forcimi i rolit të komitetit të auditimit për mua është i gjetur. Pra, komuniteti i auditimit të mos emërohet nga ministri, flas në këtë situatë që jemi për në shtet, por të gjendet një strukturë, që të bëjë emërimet që të mos varet, sepse po u emërua nga ministri, këtu jemi, ministri të vë dhe të heq pa asnjë argument, pozitivisht apo negativisht nuk ka rëndësi. Çfarë bën kjo? E cenon punën e komitetit të auditimit.

E dyta, audituesit e brendshëm, sigurisht, informojnë drejtuesin e tyre, por duhet të raportojnë te komiteti i auditimit, i cili, siç e kanë dhe standardet, përveçse duhet të japë mendim dhe të bëjë përzgjedhjen e audituesit të jashtëm, duhet të marrë raportin dhe të ndjekë punën, të vlerësojë punën e audituesve të brendshëm. Sigurisht, ka shumë punë për të bërë atje, por ne po flasim për anën e rregullimit ligjor të kësaj çështjeje, që çon në nivel korrupsioni.

Unë e thashë në fillim, po të duam të flasim përse ndodh, si ndodh, siç e filloi edhe profesor Spiro, nuk do t'ia dilnim dot. Kështu që, jam i gatshëm që në të ardhmen të jap mendimin tim dhe të institucionit që përfaqësoj për këto gjëra, sepse korrupsioni është një çështje që na prek të gjithëve, qoftë në nivelin e jetës, qoftë moralisht, pra në të gjitha drejtimet.

Unë e vlerësoj këtë iniciativë, pra si të gjejmë rrugët që të ulim këtë nivel të korrupsionit, pra të heqim atë shprehjen që korrupsioni është vaji që vë në lëvizje mekanizmat, këtë e kanë nxjerrë ata që kanë dashur të bëjnë korrupsion.

E fundit që dua të them lidhet me çështjen e tenderave publikë. Që kur u shpikën tenderat ka mendime të ndryshme, pozitive apo negative, por derisa bëhet përzgjedhja në mënyrë ligjore, mund të duket e drejtë ose jo, nuk ka rëndësi. Atëherë, si do të themi ne që përzgjedhja është bërë e saktë dhe nuk ka korrupsion? Është kontrolli i punës së bërë, ne duhet të ngremë institucion që të kontrollojë, nuk është mbikëqyrësi, sepse në të gjitha tenderat e rrugëve ka një mbikëqyrës të punimeve, por ja që korrupsioni shkon edhe atje. Nëse ne bëjmë tendera, që nuk i kontrollojmë mbrapa, me një organizëm të pavarur, që vërtet është bërë puna e duhur, vërtet është bërë në atë projekt apo jo, atëherë ne kemi mundësinë ta parandalojmë që në prokurim korrupsionin ose ta ulim, sa të jetë e mundur, më shumë, sepse nuk mund të pretendojmë ta zhdukim tërësisht, pasi është çështje njeriu, dhe ku është njeriu në mes, është e vështirë të eliminohet korrupsioni.

Ju faleminderit!

Mirela Miti – Faleminderit, profesor!

Para se t'ua jap fjalën dy ekspertëve, Ened Topi dhe Bledar Mustafaraj, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, jo në cilësinë e moderatores, por të ekspertes së këtij komponenti përkatës, dua të identifikoj dy çështje, të cilat sapo u diskutuan nga të tre parafolësit.

Së pari, në lidhje me auditimet e fondeve publike, aktualisht, në gjetjet tona është parë nga këndvështrimi i elementit të pavarësisë dhe, bazuar në studimin e të gjitha raporteve të institucioneve tona, të akteve ligjore në fuqi, konstatohen tri çështje:

1. Në lidhje me mënyrën mbikëqyrjes, kemi tri struktura: bordi i mbikëqyrjes së kontrollit të brendshëm, i cili, me ndryshimin e ligjit që është bërë konform rekomandimeve të Bashkimit European, është në rolin e një këshilluesi. Në përbërje të tij bordi i mbikëqyrjes ka drejtuesin e strukturës së buxhetit dhe drejtuesin e strukturës së thesarit.

Kush punon në fushën e auditimit nuk mundet absolutisht që një drejtues i strukturës së buxhetit dhe i thesarit të jetë pjesë përbërëse e bordit të mbikëqyrjes, aq më tepër në rolin këshillues. Çdo institucion ka këshilltar ligjor dhe nuk mundet që një bord mbikëqyrës, që në terminologji, të luajë rolin e këshilluesit. Ne këtë e kemi evidentuar si gjetje dhe i kemi thënë që në këtë rast ky konflikt interesi duhet të shmanget.

Nga ana tjetër, ka mbivendosje, e cila identifikohet me një komitet auditimi. Pra, auditimi i brendshëm dhe kontrolli i brendshëm kanë dy struktura respektive, efektiviteti i të cilave, aktualisht, në zbatueshmëri dhe impakti që prodhon procesi i kontrollit të brendshëm, pra i të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe i auditimit duhet të qendërzohen, duke bërë propozimin që kemi identifikuar: krijimin e një bordi të vetëm të monitorimit të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm.

Nga ana tjetër, kemi auditimin e pavarur, që kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe, në zbatim të rekomandimeve të Bashkimit Europian është krijuar nënkomisioni parlamentar. E diskutova pak më parë dhe pyeta: a mundet që ky nënkomision, edhe pse ne duam me shumë forcë dhe vullnet të mirë të sigurojmë pavarësinë, parlamentar me tri vetë të identifikojë efektivitetin e zbatueshmërisë së rekomandimeve? Një pjesë e mirë këtu janë ekspertë në fushën e auditimit, raporti i auditimit nuk mund të jetë kurrë detyrues, është thjesht dhënie e një opinionit të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, nuk mundet kurrësi ti të detyrosh strukturën.

Çfarë identifikojmë ne në raportet dhe gjetjet tona? Parlamenti është baza kryesore e monitorimit, është forca kryesore, që monitoron buxhetin dhe paralelisht me këtë ne kemi edhe një fenomen tjetër. Tre struktura si mund të argumentohen në një të vetëm? Më gjerë do të flasim edhe ekspertët e tjerë.

Elementi i dytë ka të bëjë me luftën antikorruption. Ndoshta ne e përmendëm shumë pak, por krijimi i strukturave respektive në lidhje me Drejtorinë e Përgjithshme Antikorruption, edhe pse e krijuar në një interval shumë të shkurtër kohor, tashmë ka dhënë rezultatet e veta pozitive. Nga ana tjetër, kemi ILDKPI-në, e cila bën vetëm deklarimin e pasurive të zyrtarëve të lartë. Këtu shtrohet pyetja: a mundet që korrupsioni të vijë vetëm nga zyrtarët e lartë? Fokusi i korrupsionit vetëm te këta zyrtarë do të bëjë të mundur që të fokusohesh në procese të tilla, ndërkohë që lufta kundër korrupsionit duhet të jetë gjithëpërfshirëse.

Këto janë çështjet dhe tezat për diskutim.

Unë do t'i jap fjalën Bledarit për të identifikuar çështjet.

Bledar Mustafaraj – Faleminderit, Mirela!

Unë jam Bledar Mustafaraj, në këtë grup pune kam përfaqësuar Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Gjej rastin t'ju falënderoj të gjithëve për mënyrën se si e kemi realizuar këtë proces dhe kemi arritur në dokumentin që është sot paraqitur!

Pa dashur të bie në përsëritje dhe në vijim të fjalës që zonja Kovaçoviç mbajti, si përfaqësuese e NDI-së, një ndër gjetjet që kemi hasur në dokumentacionin që kemi marrë në shqyrtim, që ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë proceseve të auditimeve, lidhur me këtë Parlamentin shqiptar, duke pasur parasysh mënyrën e organizimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe natyrën juridike të rekomandimeve që ai jep në përfundim të proceseve të auditimeve, e ka parë të arsyeshme që të muajin korrik të këtij viti të ngrejë një nënkomision të posaçëm parlamentar pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, i cili do të merret me ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Nuk është i përbërë nga tre anëtarë, ndjesë Mirela, nëse të korrigjoj, sepse ka një numër të caktuar deputetësh, të cilët janë duke nisur punën e tyre, kanë caktuar seancat e para për të marrë në shqyrtim disa prej raporteve të auditimit të performancës, për të parë dhe për të marrë të dhënat nga institucionet e audituara lidhur me mangësitë, problematikat apo arsyet e moszbatimit të rekomandimeve, që pastaj do të përkthehen në ndërhyrje konkrete nga ana e Parlamentit, nëpërmjet mekanizmave që Kushtetuta dhe i gjithë legjislacioni në Shqipëri parashikon. Kështu që, mendoj se kjo pjesë është ezauruar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga të gjitha rekomandimet që janë lënë nga Komisioni Europian në këtë fushë.

Faleminderit!

Ened Topi – Në përgjigje të disa vërejtjeve ose komenteve të zotit Brumbulli në lidhje me masat ndëshkuese, po, ne kemi rekomanduar disa masa ndëshkuese, në të vërtetë një. Ndryshimi i fundit i ligjit, që ashpërsoi masën ndëshkuese, ishte rekomandim i Bashkimit Europian, ndërsa ne kemi rregulluar një lapsus, që gjendet në një akt nënligjor në lidhje me këtë inercinë apo pazbatueshmërinë e bashkëpunimit nga titullarët e institucioneve publike.

Sa u takon strukturave të tepërta, kemi një mori strukturash, që kanë pak a shumë të njëjtin funksion: Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion, ILDKPI-në, drejtoritë antikorrupsion pranë Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë së Tatimeve e të tjera. Sigurisht, në raportin tonë ka edhe për këto institucione apo për këto struktura gjetjet përkatëse, dhe një nga gjetjet kryesore

është thjeshtëzimi i këtyre strukturave, pra të gjejmë një mënyrë apo metodë, jo që t'i përqendrojmë të gjitha kompetencat në një strukturë të veçantë, por të paktën të racionalizohen kompetencat e këtyre strukturave.

Sa i përket një komenti shumë të vlefshëm të zotit Dharmo, po, jam shumë i bindur që ne vuajmë nga moszbatimi i ligjit, jo nga mungesa e ligjeve. Doja vetëm të theksoja faktin që grupi i punës në punën e tij është fokusuar në një mori dokumentesh, besoj se ka akoma punë për të bërë, rekomandimet tuaja janë shumë të vlefshme dhe ne i mirëpresim.

Ju faleminderit!

Mirela Miti – Faleminderit!

Po.

Aranita Brahja – Unë dua ta falënderoj zotin Brumbulli, që e dëgjoji me vëmendje propozimin. Në fakt, te kompanitë me zotërim publik, jo vetëm në tryezën e sotme dhe në punën e grupit tonë, por edhe tek antikorupsioni, janë dhënë shumë masa, dhe duket sikur jemi në kushtet e nevojës për një moratorium për menaxhimin e shoqërive publike. Dua vetëm të saktësoj, sepse ndoshta është keqkuptuar, ne kemi propozuar që të bëhen transaksione përmes llogarive të thesarit të shtetit vetëm për atë pjesë të parave që këto kompani marrin drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit, dhe në asnjë moment nuk kemi synimin që kompanitë të ndryshojnë statusin e tyre, si shoqëri tregtare, dhe të kthehen totalisht të centralizuara, pasi kemi konstatuar që ka shumë programe kombëtare, të cilat humbasin transparencën ndaj publikut, duke u kaluar këtyre kompanive, dhe pastaj nuk arrijmë të kuptojmë as si është bërë transaksioni financiar dhe as prokurimi publik.

Mbase është me vend ta them, kemi qenë të detyruar jo për të ndryshuar rolin liberal, që duhet të ketë funksioni i këtij sektori, pra shoqëritë me zotërim publik, që janë shoqëri tregtare, por, për shkak të një situatë pa vëmendjeje, mjafton të përmend që pronat dhe asetet e këtyre kompanive janë të tjetërsueshme në bazë të një ligji special (akt normativ i qeverisë së vitit 2008) që, për fat të keq, u liberalizua me një ndryshim të vogël edhe në vitin e fundit, pra para disa javësh. Çka do të thotë se sot një kompani nuk ka nevojë të auditohet, sepse auditu vjen dhe pyet: si u privatizua ky aset, ky terren? Rezultati është shumë i thjeshtë: u privatizua me këtë ligj.

Ky ligj është tepër i vjetër, tepër problematik dhe tani ky ligj ka mundësi të ofrojë një shkëmbim. Pra, kemi një pronë shtetërore në mes të Tiranës, që e shkëmbejmë me një pronë në një zonë pa shumë vlerë, dhe ligji nuk e ka detyruar shoqërinë as të bëjë një rivlerësim paraprak,

sipas llogarisë së tregut, as të bëjë një regjistrim në regjistrin e pronave të paluajtshme, as të bëjë një transparencë përmes instrumenteve të ankandit apo të prokurimit publik.

Unë kam ndjekur para një jave me vëmendje edhe tryezën që u bë për antikorrupsionin, sepse këtu jemi disa tryeza, dhe shumë çështje të shërbimit publik janë trajtuar edhe nga kolegë të tjerë, dhe shoh që për këtë sektor jemi në kushtet që jo vetëm kontrolli financiar, por edhe ligji, sepse audit mund të shkojë e të thotë: është bërë kështu, por ai të thotë se kështu është shkruar ligji. Pra, jemi aty ku ligjet na japin mundësi të bëjmë korrupsion dhe të mos ndëshkohemi pranë auditimit apo hetimit të një institucioni tjetër.

Kjo ka qenë nevoja, pra duket sikur biem në kundërshtim me tregun, sepse kërkojmë që shoqëritë të disiplinohen, por është një rrethanë që ka të bëjë me legjislacionin, që na kërkon të vëmë një zonë risku me të kuqe dhe të themi se kjo zona e riskut duhet evidentuar.

Mirela Miti – Faleminderit, zonja Brahaj!

A ka diskutime nga të tjerët?

Po, zonja Gjonaj, fjala për ju.

Etilda Gjonaj – Shumë shkurt, sepse jemi në limitet e organizimit të kësaj tryeze, megjithatë më lejoni të falënderoj ekspertët e të dyja shtyllave të këtij komisioni, të mirëqeverisjes dhe të antikorrupsionit, për diligjencën e treguar në analizën e përgatitur. Pa dyshim, duhet të mirëkuptojmë edhe dëshirën për të bërë disa sqarime, sepse kjo është një temë shumë komplekse. Duke bashkuar aspektet e të dy komponentëve, si aspektin e mekanizmave për mirëqeverisjen, ashtu edhe aspektin e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, e bëjnë atë të jetë paksa më e ngarkuar.

Nga ana tjetër, besoj se çdo diskutim sot dhe çdo kontribut që do të vijë në vijim do të jetë me shumë vlerë. Jam e bindur që edhe ekspertët, në këtë produkt të tyrin, do t'i reflektojnë komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e të gjithëve në këtë tryezë, por edhe përtej.

Siç e thashë, është një fushë shumë komplekse, bashkë me Milvën jemi munduar të mbështesim ekspertët për të përgatitur këtë dokument analitik, në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme, për të treguar një pasqyrë reale të problematikave që ekzistojnë, duke përmendur edhe arritjet.

E fundit, meqë edhe unë vetë vij nga sektori i shoqërisë civile dhe akademike, përpara përfshirjes sime në politikë, kam pasur bindjen se ne kemi ekspertë dhe kapacitete shumë të mira, të cilët janë si ekspertë lokalë. Edhe me këtë komision, me këtë proces që kemi ndërtuar,

vazhdoj dhe më është forcuar bindja se ekspertiza, kapacitetet lokale, si në akademi, ashtue dhe në shoqërinë civile, janë shumë të mira, e vetmja gjë është si t'i motivojmë më shumë.

Ndaj, ju falënderoj shumë për të gjithë punën dhe angazhimin tuaj të padiskutueshëm, shumë intensiv dhe me një rezultat shumë të mirë!

Një falënderim të fundit për të gjithë aktorët ndërkombëtarë, duke përfshirë delegacionin e Bashkimit European, ambasadën e SHBA-ve, NDI-në, OSBE-në, UNDP-në, Këshillin e Europës, të cilët jo vetëm kanë dhënë mbështetjen politike, por do të fillojnë dhe janë në pjesën e procesit të asistencës teknike, që do t'i japë një vlerë të shtuar të gjithë dokumentit analitik të ekspertëve lokalë!

Edhe një herë, ju falënderoj të gjithëve për durimin dhe për pjesëmarrjen aktive!

Mirela Miti – Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit